



Raport Paraprak

Vlerësimi i Ndikimit në Mjedis i LINJËS SË PRODHIM, AMBALAZHIM TË UJIT DHE PIJEVE JO ALKOLIKE, (burimi Selita & ShënMëria) **PËR SUBJEKTIN RIS sh.p.k. QESARAK TIRANË** *Përgatitur nga Departamenti i Gjeomjedisit - G & G group*



Autorë:

Prof.asc.	Sazan	GURI	(Ekspert Mjedis)
M. Sc.	Marianthi	GURI	(Ekspert gjeo-mjedis)
M. Sc.	Denisa	BALO	(Ekspert Shendetit Publik)

Tiranë, Qershor - 2017

PËRMBAJTJA

II. RAPORTI PARAPRAK I VNM-së

- 2.1 PËRSHKRIMI I MBOLESËS BIMORE
 - 2.2 INFORMACION PËR PRANINË E BURIMEVE UJORE
 - 2.3 INFORMACION PER IDENTIFIKIMIN E NDIKIMEVE TË MUNDSHME
 - 2.3.1 Ndikimi negativ në mjedis
 - 2.3.2 Ndikimet në biodiversitet
 - 2.3.3 Ndikimet në ujë
 - 2.3.4 Ndikimet në tokë
 - 2.3.5 Ndikimet në ajër
 - 2.4 SHKARKIMET E MUNDSHME NË MJEDIS
 - 2.4.1 Shkarkimet e ujërave të ndotura
 - 2.4.2 Gazet
 - 2.4.3 Pluhërat
 - 2.4.4 Zhurmat
 - 2.4.5 Vibrimet
 - 2.4.6 Prodhimet e mbetjeve
 - 2.5 INFORMACION PËR KOHËZGJATJEN E NDIKIMEVE NEGATIVE
 - 2.6 TË DHËNA PËR SHTRIRJEN E HAPËSINORE TË NDIKIMIT NEGATIV
 - 2.6.1 Distancën fizike nga vendndodhja e projektit
 - 2.6.2 Vlerat e ndikuara
 - 2.7 MUNDËSINË E REHABILITIMIT TË MJEDISIT TË NDIKUAR
 - 2.7.1 Mundësinë e kthimit të mjedisit të ndikuar në gjëndjen e mëparshme
 - 2.7.2 Kostot financiare të përafërta për rehabilitim
 - 2.8 MASAT E MUNDSHME PËR SHMANGIEN
 - 2.8.1 Zbutjen e ndikimeve negative në mjedis
 - 2.9 NDIKIMET E MUNDSHME NË MJEDISIN NDËRKUFITAR
- III. PËRFUNDIME DHE REKOMANDIME
- 3.1 PËRFUNDIME
 - 3.2 REKOMANDIME
- IV. STUDIME MBËSHTETËSE

HYRJE

Nga Kompania RIS sh.p.k., që kërkon të ngrejë një fabrikë për prodhim, ambalazhim uji dhe pijeve joalkolike, Studio - G & G Group”, me qendër në Tiranë mori përsipër, të kryejë Raportin Paraprak të Vlerësimit të Ndikimit Mjedisor PËR PRODHIMIN DHE AMBALAZHIMIN E UJIT me etiket **RIS sh.p.k.** për subjektin RIS sh.p.k. (Burimi Selita e Shenmeria), LANABREGAS - TIRANË, që ndodhet në kodrat e malit të Dajtit në mbështetje të një aktiviteti të qëndrueshëm dhe afat gjatë në mjedis, të zonës në të cilën do të zhvillohet për pajisjen me leje mjedisi në përputhje me ligjin ligji nr. 10 448, datë 14.7.2011 “Për lejet e mjedisit” të parashikuar në kategorinë III.2 të shtojcës së Ligjit Nr. 10 081.

Procesi i vlerësimit të ndikimit në mjedis bazohet në Legjislacionin Shqiptar dhe atë ndërkombëtar. Procesi i vlerësimit të ndikimit në mjedis siguron një përmbledhje të informacionit të disponueshëm në përputhje me kushtet e vend-ndodhjes së fabrikës, duke përfshirë kushtet fizike dhe atmosferike, burimet ujorë dhe biologjike, kulturën dhe kushtet social-ekonomike të zonës. Metoda e përshtatshme për vlerësimin e ndikimit në mjedis është ajo e list-kontrollit, e cila vendos nga njëra anë të gjitha burimet e mundëshme të ndikimeve dhe nga ana tjetër bartësit e ndikimeve, si dhe parashikimin e madhësisë së ndikimit. Madhësia e ndikimit është shprehur me një sistem prej 5 shkallësh (+) dhe (-). Në këtë studim jepen në detaje:

- Mundësitë për teknologji të pastër;
- Rritje dhe zhvillim të qëndrueshëm;
- Shqyrtimi i alternativave të ndryshme brënda projektit.
- Vlerësimi cilësor me pike të ndikimeve në mjedis të projektit.
- Propozimeve të masave zbutëse të ndikimit të projektit.

Zona në vetvete nuk do të ketë karakterin specifik vetëm dhe thjesht të një zone prodhuese, në të cilin do të ndodhin procese fiziko-kimike të transformimit të ujit, sigurisht konsum të energji natyrore, si uji. Në kuptimin e thjeshtë, ajo do të jetë fabrikë, ku do të ngrihet veç impiantit të domosdoshëm për prodhimin e ujit edhe ambalazhimi i ujit në bidona plastikë 2 litër, 10 litër dhe 8 litra, si edhe pijeve jo alkoolike.

Kërkesat e procesit të vlerësimit të mjedisit

Procesi i vlerësimit të ndikimit në mjedis, paraqet masa lehtësuese për të minimizuar ose për të ndaluar ndikimet sociale dhe mjedisore të projektit. Këto përfshihen në një Plan Menaxhimi Ambiental (PMA), i cili mund të shihet i detajuar në raport. PMA konsiston në vendosjen e masave lehtësuese, monitoruese dhe institucionale, që do të ndërmerren gjatë ndërtimit dhe operimit për të eliminuar, kompesuar ose për të zvogëluar ndikimet ambientale dhe sociale. Plani, gjithashtu përfshin veprimet, që nevojiten për të zbatuar këto masa. Procesi i vlerësimit të ndikimit në mjedis përcakton menaxhimin specifik mjedisor e planet monitorues dhe identifikon të gjitha nevojat e raportuara, si dhe afatet.

Â Vlerësimi i ndikimeve potenciale

Pas identifikimit duhet të parashikohet madhësia dhe natyra e ndikimit në mjedis. Parashikimet bëhen mbi ndryshimet potenciale në çdo parametër mjedisor, si në shmangien e ndotjes së ajrit, zhurmave dhe cilësisë së ujrave.

Ã Vlerësimi i ndikimeve reale

Ndikimet reale mund të përcaktohen, duke vlerësuar po këto ndikime ndaj:

- standarteve mjedisore;
- rregullores së shfrytëzimit të burimeve të ujit;
- preferencave të publikut dhe oponencave të specialistëve;

Ã Identifikimi i masave zbutëse

Kur një ndikim vlerësohet si i papranueshëm, atëherë kërkon mjete dhe masa zbutëse dhe mbrojtëse, që përfshijnë ndryshimin e metodave dhe parashikim masash lidhur me kohën e zbatimit, mënyrën dhe mjetet që do të përdoren si:

- Kompesim për burime apo sipërfaqe të dëmtuar;
- Vëzhgim i zbatimit të masave zbutëse;

Ã Vlerësimi i shumëllojshmërisë së gjallesave, florës dhe faunës

- Konventa e Diversitetit Biologjik përkufizon shumëllojshmërinë e gjallesave si: “Llojshmërinë e organizmave të gjalla dhe komplekset të cilat ato u përkasin. Kjo përfshin ndryshueshmërinë brenda specieve dhe të vetë ekosistemeve”. Matësit e shumëllojshmërisë së gjallesave përfshijnë elementë si ndryshueshmërinë gjenetike brenda specieve, etj.

Ã Identifikimi i ndikimit dhe lehtësimet e propozuara

Ndikimet e mundshëm pozitivë dhe negativë të projektit të propozuar janë identifikuar dhe matur në masën më të konsiderueshme të mundur. Gjithashtu, në këtë raport përfshihen informacione mbi masat lehtësuese, që duhen marrë për pakësimin e ndikimeve negative, gjatë ndertimit të fabrikës së ambalazhimit të ujit në burimin e Selites, si dhe mbi ndonjë ndikim negativ të mbetur, që mund të lehtësohet. Gjithashtu, ky raport identifikon dhe vlerëson shtrirjen dhe cilësinë e të dhënave në dispozicion, të dhënat kryesore për boshllëqet, si edhe paqartësitë e shoqëruara me parashikime dhe rekomandime.

I. RAPORTI PARAPRAK I VNM-SË

1.1. PROCESI I VLERËSIMIT TË NDIKIMIT

Qëllimi i VNM, është të sigurojmë informimin për një mjedis të pastër dhe të shëndetshëm dhe ndërgjegjësimin e publikut, që nëpërmjet vlerësimit cilësor e sasior paraparak të parametrave ekologjik, të treguesve hidrogeologjikë e hidrologjikë, morfologjik e gjeomorfologjik, parametrave sizmo-tektonik, të bazuara në kriteret standarte shkencore ndërkombëtare, sipas Konventave Ndërkombëtare e Kombëtare, të tipizohen dhe të përzgjidhen një sërë parametrash dhe veçorish të sistemeve natyrorë, në shërbim të menaxhimit të infrastrukturës mjedisore, të mbrojtjes së aksidenteve, të përmirësimit të kushteve të punës të funksionimit të kësaj fabrike. Ky raport vlerësimi ka për qëllim:

- Paraqitjen e gjendjes sa më reale, nga pikëpamja e ndikimit të këtij aktiviteti, mbi mjedisin natyror dhe human;
- analizimin e faktorëve pozitivë e negativë mjedisore;
- dhënien e masave zbutëse, si për reduktimin e ndikimeve negative;
- planin e menaxhimit lokal dhe monitorimet për zërat përkatëse.

Funksionimi i këtij objekti është bazuar në një projekt kompleks me shfrytëzimin e ujit nga burimi i Selites, imbutim, ambalazhim, analizim i parametrave fiziko-kimik, si dhe bakterologjike etiketimin, magazinimin dhe transportimin deri tek njësite tregëtare të shitjes me shumicë dhe pakicë, në mënyrë që të realizojë në përmbushjen e të gjitha qëllimeve. Ky prioritet ndaj zhvillimit të industrisë së ujit të pijshëm ndërmeret si një iniciativë që do të tentojë, përveç rritjes së fitimit të investitorit edhe në:

- Shfrytëzimin dhe përdorimin e burimeve ujore në vend me standarte dhe cilësi;
- Rritje e cilësisë së jetës për qytetarët;
- Përdorimin e pasurive natyrore ujore;
- Zbatimi i rregullores së sigurimit teknik mbrojtjes në punë dhe MKZ;
- Ruajtjen e vlerave ekologjike të peizazhit;
- Zhvillim i biznesit lokal;
- Rritjen e punësimeve në këto nivele;
- Kompesimet në komunitetin e Komunës Dajt.

1.2. METODIKA

Studimi i Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis u orientua nga madhësia e projektit, vendi ku ai ndodhet, pasuritë natyrore dhe humane të zonës, si dhe vlerat e veçanta të tyre, identifikimi i ndikimeve negative dhe pozitive, marrja e masave zbutëse, duke patur parasysh edhe ruajtjen e interesave ekonomike të investitorit dhe masat orientuese për një zhvillim të qëndrueshëm të projektit. Në këtë studim identifikohen ndikimet pozitive dhe negative në natyrë dhe në mjediset humane, si dhe është marrë parasysh dhe vlerësimi i rrezikut. Reduktimi i ndikimeve negative është ndërthurur edhe me ndikime të rëndësishme pozitive, sidomos në kompesime indirekte mbi komunitetin. Studimi është kryer duke u ndarë në fazat kryesore si:

1. Ngritja e objektivave orientuese të projekt-studimit;
2. Mbledhja e materialit bazë ekzistues dhe atij të formuluar enkas për këtë projekt dhe seleksionimi i saj për përdorim;
3. Verifikimi në terren i të dhënave ekzistuese dhe mbledhja e të dhënave të mundshme biofizike dhe humane;

4. Hartimi i projektit dhe dorëzimi tek porositësi, si dhe tek subjektet vendim-marrëse dhe kontrolluese të aspekteve mjedisore, në nivele qendrore dhe lokale;

Metodologjia e përdorur

Për realizimin e studimit të VNM-së u kryen:

a. Vrojtime në terren në rajon të gjerë, duke kryer vrojtime hidrologjike, pedologjike, gjeomorfologjike, ekologjike, si edhe, të shumëllojshmërisë së gjallesave, të përdorimit të tokës. Për të realizuar objektivat e këtij studimi janë marë:

- foto në territorin në studim;
- takime me ekspertët lokal dhe komunitetin e zonës;
- takime me specialistë të zonës;

b. Argumentimi i bazuar mbi vlerësimin e:

- Studimi dhe skema e zhvillimit teknologjik;;
- inventaret e të dhënave ekzistuese;
- informacionet bazë, në botimet periodike mbi këtë zonë;
- Pajtueshmëria me kërkesat ligjore si cilësia e ajrit, shkarkimet ujore, niveli i zhurmave dhe mbetjet inerte.

c. Vlerësimin me metodën e listë-kontrollit, e cila vendos nga njëra anë të gjitha burimet e mundshme të ndikimeve dhe nga ana tjetër bartësit e ndikimeve, si dhe parashikimin e madhësisë së ndikimit. Madhësia e ndikimit është shprehur me sistem prej 5 shkallësh (+) dhe (-). Burimet kryesore, për punimet e ndertimit të kësaj fabrike janë:

- Mbatja pastër e mjedisit përreth dhe në standarde të kënaqshme, pa shkaktuar mbetje ose ndotje, për të ruajtur kushtet ekologjike të zonës;
- përdorimi i tabelave orjentuese për shmangien e aksidenteve;
- ruajtja e pastertise dhe e kushteve higjieno-sanitare te aparaturave dhe paisjeve te fabrikes se ambalazhimit të ujit;
- Mbrojtja e kushteve ekologjike perreth fabrikes sipas standarteve;

Nga Institucionet e specializuara, sipas porosisë së AKM/MM mund të kryhen monitorimet si më poshtë:

- Monitorimi i ajrit, nuk ka nevojë të kryhet
- Përsa i përket zhurmave, frekuencat e monitorimit do të përcaktohen nga specialistët e kësaj fushe pranë inspektoriateve përkatëse;
- Monitorimi i ujit te ambalazhuar, do të kryhet sipas standarteve të Institutit te Shendetit Publik.

Ndikimet potenciale mjedisore të shqyrtuara dhe të analizuara në procesin e VNM duhet të japin ndikimet ndaj cilësisë së ujit te ambalazhuar, burimet ujore, situatën social-ekonomike te zones ne studim. Shoqëria investuese do të mirëpresë, ndihmojë dhe lehtësojë, çdo inisiativë vëzhguese mjedisore, që do t'i këshillohet në "lejen mjedisore", në shërbim të së cilës është kryer edhe ky studim. Gjithashtu, inspektimet nga specialistët e autorizuar të shëndetit publik dhe mjedisit do të mbështeten në çdo kohë nga kjo shoqëri për realizimin e auditimeve mjedisore dhe shëndetësore.

II. PËRSHKRIMI I MBULESËS BIMORE

Zona në studim bën pjesë në njësinë fiziko-gjeografike të Krahinës Malore Qëndrore të Shqipërisë. Nga pikëpamja strukturore kemi të bëjmë me antiklinalin e Dajtit. Relievi i kësaj zone karakterizohet nga një pjerrësi e madhe e terrenit dhe shumica e ndërtesave të reja, e vendosur në luginën e Gjebrezës. Rajoni ndodhet shumë pranë kryeqytetit. Zhvillimi i qëndrueshëm në rajon do të jetë udhëzuesi kryesor për ndërhyrjet. Për këtë duhet që konsideratat ekonomike, shoqërore e ekologjike të ekuilibrohen me mirë zhvillimin rajonal. Lartësia e territorit është rreth 300m mbi nivelin e detit. Zona në studim shtrihet në lindje të Tiranës, dhe përfshin territorin administrativ të Komunës Dajt. Fabrika ka një sipërfaqe prej afërsisht 200m².

2.1. VEGJETACIONI DHE BIODIVERSITETI

Para viteve 90, pylli, flora dhe fauna janë një pjesë e pa ndashme e një ekosistemi. Nga çpyllëzimi, flora dhe fauna janë ekspozuar ndaj fenomenit antropogjen, duke vënë në kërcënim zhdukjen e habitateve të krijuara ndoshta 100-ra vjeçare. Mund të përmendim lepurin, dhelprën, çakallin, qelbsin, nuse lalen, etj. Pas vitit 90, pylli po rigjenerohet me ritme më të shpejta se flora dhe fauna. Sensibilizimi i komunitetit për ruajtjen e florës dhe faunës nuk është në nivelet e dëshiruara, dhe si rrjedhojë ndodhin fenomene që çojnë në prishjen e ekuilibrave mjedisore. Meqënëse llojet potenciale të kësaj ekonomie janë brenda arsenalit të tyre dhe kushteve stacionale optimale vetkuptohet që prespektiva vegetative është e mirë, por ndërhyrja e njeriut me dëmtime nëpërmjet prerjeve abuzive dhe kullotjes intesive ka dëmtuar zhvillimin normal të tyre duke degraduar pjesën më të madhe të sipërfaqes pyjore. Edhe për pyllëzimet e reja do të ndërhyhet me lloje ekzistuese, duke kryer pyllëzime në sipërfaqet me bimësi pyjore dhe vendet e zhveshura e të erodhuara me lloje me rritje të shpejtë dhe që gjejnë kushte normale për rritje e zhvillim.


Relievi, klima, ujërat dhe tokat, kanë kushtëzuar florën dhe faunën e komunave. Në komunën Dajt dallohen qartë këto kate bimore:

- *Kati i shkurreve mesdhetare*, që shtrihet në lartësitë 300-600 m, ku janë zhvilluar makiet, xina, mërsina, murrizi, gjineshtra, sherebela dhe manaferra si bimë karakteristike e zonës;
- *Kati i dushqeve*, që shtrihet nga 500-600 m deri në 1000-1300 m lartësi dhe ku ndërthuren gështenja dhe lloje të tjera drurësh. Pyjet e dushkut përbëhen nga lloje të lisit gjethe gjerë (*Quercus frainetto*, *Quercus cerris*, *Quercus petraea* dhe *Quercus trojane*) ose faza të degraduara të lisit *Carpinus orientalis*, *Carpinus betulus*, *Fraxinus ornus*, *Juniperus oxycedrus*, *Prunus spinosa*, *Pyrus amygdaliformis*,
- *Paliurus spina-cristi* Ky brez zhvillohet midis atij të shkurreve mesdhetare dhe pyllit të ahut. Lartësia ndryshon nga 500 m deri në 1100 m mbi nivelin e detit. Duke qenë afër vendbanimeve, ky kat bimor është shumë i ekspozuar ndaj shfrytëzimit dhe dëmtimit nga njeriu dhe bagëtitë;
- *Kati i ahut*, që shtrihet në lartësitë 1000-1600 m, përfaqëson një formacion pyjor të rëndësishëm, me drurë ahu 200 vjeçar, me vlerat e monumenteve natyrore të çmuara. Këtu



gjenden edhe sipërfaqe të vogla halorësh, si *Pinus nigra*, *Pinus leucodermis*, bredhi i bardhë, arneni i bardhë, rrobulli etj.

- *Kati i kullotave alpine*, që shtrihet në një sipërfaqe të kufizuar mbi 1600m lartësi. Ato shfrytëzohen pa ndonjë plan konkret dhe pa studime për përmirësimin e tyre. Ndër bimët *endemike* është *Ramonda serbica* e familjes *Gesneriaceae*, që zhvillohet në faqen lindore të malit të Dajtit.



2.2. Fauna dhe gjuetia

Ekonomia e pyjeve në Komunën për vetë pozicionin gjeografik është e pasur dhe me një faunë të larmishme e të konsiderueshme që nga shpendët deri tek kafshët e egra. Llojet kryesore këtu janë lepuri, dhelpira, çakalli, qelbësi, nuse lala. Kushtet e jetesës dhe ekzistenca e gjahut janë optimale, por duhen përmirësuar akoma në të ardhmen nëpërmjet mbarështrimit të integruar të tyre. Në zonën tonë nuk ka shenja për gjueti.

Fauna është e larmishme dhe e shprehur mirë, megjithëse e shqetësuar nga veprimtaria e pakontrolluar e njeriut. Në këtë zonë gjejë kushte të përshtatshme gjitarët e mëdhenj si derri i egër, ujku, baldosa, dhelpira etj, ndërsa ariu është vizitor i rrallë. Nga gjitarët e tjerë të lidhur me pyjet fletore janë ketri, kunadhja, macja e egër etj. Nga shpendët rriten harabelat, gardalinat, trishtilat, qukapikët, grifshat, gushëkuqi, mëllenja etj.

Zona është e pasur me lloje të quajtura “vlera natyrore”, nga të cilët katër janë amfibë, tetë zvarranikë, 11 shpendë dhe nëntë gjitarë.


Fauna e PK të Dajtit është e pasur dhe e shumëllojshme. Inventarizimi i grupeve ka treguar se ka shumë lloje që paraqesin një trashëgimi të rëndësishme në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar

Habitatet dhe biodiversiteti

Prania e shtresës së pasur me humus, si dhe një farë prezenceje e sasisë të ujit, në gjithë zonën bënë që zona përreth (kodrinat) të jetë e pasur me vegjetacion. Habitatet bazë të zonës përreth territorit të kërkuar për shfrytëzim klasifikohen në:

- Habitate ujore
- Habitate gjysëm të lagura dhe shkurre të ulta
- Habitate të hapura dhe livadhore

Territori që merret në shqyrtim ka veçori, çka e bëjnë më të përshtatshme për shfrytëzim urban në krahasim me zonat e tjera përreth. Përzgjedhja e kësaj zone është bërë, duke patur parasysh afërsinë dhe komunikimin me jetën e gjallë shoqërore, si edhe elementin ekologjik. Mungesa e zhvillimit të vegjetacionit të rritur e bëjnë këtë territor të pafavorshëm edhe për faunën e lartë. Për këtë arsye, edhe fragmentizimi i habitatit, për shkak të zhvillimit të projektit, mund të konsiderohet si relativisht shumë i parëndësishëm.



2.3. Sistemi natyror sizmologjik

Nga pikëpamja sizmotektonike, zona mund të goditet në të ardhmen nga tërmete me magnitudë $M_{max} = 5.5-5.9$ gradë Richter, ndërsa sipas hartës së tërmeteve maksimale të mundshëm, qyteti i Tiranës përfshihet në zonën me $M_{max} = 5.8-6.4$. Mbështetur në hartat e rrezikut sizmik, në formë probabilitare, qyteti i Tiranës dhe rrethinat e tij përfshihen në zonën ku, lëkundjet e truallit me intensitet $I_0=8$ ballë ($PGA = 0.2$ g) ndodhin çdo 200-250 vjet. Nga ky këndvështrim, për të shmangur rreziqet nga tërmetet, del për detyrë të studiohen:

- Dukuritë e lëngëzimit të rërave, të vrojuara nga tërmetet e së kaluarës;

- Tërmete me intensitet maksimal të mundshëm;
- Vetive fiziko mekanike të rërave;
- Vlerësimi të potencialit të lëngëzimit të rërave të zonës.

Ndër treguesit e pafavorshem gjeoteknik, më kryesoret janë:

- Sizmiciteti i lartë (Magnitude VIII - IX, sipas shkallës Rihter);
- Lëngëzim i paneglizhueshem i rërave;
- Sipërfaqja e tokës në studim janë të qëndrueshme ndaj erozionit, për shkak të mospjerrësisë së saj, megjithë pranisë së rrjedhave ujore sipërfaqesore

Ndër treguesit e favorshem gjeoteknike, më kryesoret janë:

- prania e shkëmbinjve mesatarisht të fort, si ata në rastin konkret;
- kushtet hidrogjeologjike e gjeomorfologjike per kthimin e kesaj siperfaqe pjesërisht në zonë urbane.

Veprimtaria sizmike

Nga zona e shkëputjeve aktive të Tiranës janë gjeneruar shumë tërmete, ndër më të fuqishmit janë: tërmeti i vitit 1617 me $I_0 = 8$ ballë (MSK-64) në Krujë; tërmeti i 26.08.1852 me $I_0 = 8$ ballë (MSK-64) në Kepin e Rodonit; tërmeti i 13.05.1860, me $I_0 = 8$ ballë (MSK-64) në Urën e Beshirit; tërmeti i 04.02.1934 me $M = 5.6$ dhe $I_0 = 7$ ballë (MSK-64) në Zonën e Vrapit; tërmeti i 16.09.1975 me $M = 5.3$ në Kepin e Rodonit; tërmeti i 22.11.1985 me $M = 5.5$ në gjirin e Drinit; tërmeti i 09.01.1988 me $M = 5.7$ në Tiranë.

Karakteristikat sizmotektonike të zonës

Tërmeti më i fortë që ka goditur Tiranën është ai i datës 09.01.1988, me $M = 5.7$ (ISC) dhe intensitet $I_0 = 7-8$ balle (MSK-1964). Nxitimi maksimal arriti $PGA=0.4g$ në komponenten L-P, $PGA = 0.1 g$, në komponenten V-J dhe $PGA = 0.07 g$ në komponenten vertikale Z ndërkohë që kohëzgjatja e tij nuk i kaloi 6 sekondat.

Sipas hartës së rajonizimit sizmik, rajoni përfshihet në një zonë, ku brenda 100 vjetëve të ardhshëm mund të priten tërmete me intensitet $I_0 = 7$ ballë, MSK-64 për kushte mesatare trualli. Zona nga pikpamja gjeologjike, zë vend në sinklinalin e Tiranës midis kundërhypjes aktive, që e kufizon nga perëndimi dhe mbihypjes aktive, që komplikon krahun e përmbysur të antiklinalit të Dajtit.

III. INFORMACION PËR PRANINË E BURIMEVE UJORE

Pozita gjeografike e zonës në studim, si pjesë përbërëse e Ultësirës Bregdetare, relievi kodrinor, vargmalet që e rrethojnë dhe e mbrojnë nga erërat e ftohta kontinentale, etj. janë ndër faktorët kryesorë, të përgjithshëm e lokal, që kushtëzojnë veçoritë klimatike të zonës tonë. Sikundër dhe Ultësira bregdetare edhe rajoni ynë gjendet nën ndikimin e fuqishëm të Adriatikut, sidomos në shpejtësinë e erës dhe regjimit të saj karakteristik gjatë stinës së verës. (F. Krutaj 1991). Nga pikepamja hidrogeologjike, rajoni ynë ben pjesë në pellgun e madh artezian, i cili është i pasur me ujra nëntokësore dhe burime sipërfaqësore.

Ushqimi kryesor i rrjetit hidrografik janë reshjet e shiut, gjë kjo që shprehet edhe në veçoritë e regjimit të rrjedhjes vjetore. Në stinën e verës, prurja e përrrenjve pakësohet aq shumë, sa që një pjesë e tyre që e furnizojnë thahet plotësisht. Kjo vjen nga mungesa e reshjeve gjatë verës, por edhe nga burimet shumë të pakta e të vogla nëntokësore, për shkak të përhapjes së formacioneve të papërshkueshme.

Skema e rrjetit të kanalizimit të ujrave të bardha për Njësinë Administrative Dajt (kullim, ujitje)

Kanalet kryesorë që marrin ujë nga përrrenj atypare dhe që përshkon fshatra nuk funksionojnë për arsye, sepse nuk ka vepër marrëse.

Të dhëna për burimet ujore të zonës

Në këtë zonë ka një numër përrrenjesh të vegjël të krijuar nga zona kodrinore, veçse këto nuk mund të konsiderohen si burim serioz i ujit, pasi jetëgjatësia e tyre pas shiut është relativisht e shkurtër. Këta përrrenj sjellin ujë kryesisht gjatë stinës së lagësht, duke ndikuar në pëmbytjen e tokave të zonës fushore dhe të ndodhura pranë tyre dhe në mënyrë të veçantë nxisin shfaqjen e koeficientëve të lartë të erozionit. Tani të gjitha skemat janë në vartësi dhe nën menaxhimin privat nga vetë banorët e zonës dhe strukturat e zgjedhura prej tyre.

Burimet artificiale

Në këtë zonë ndodhen rezervuarë të vegjël, që nuk paraqesin probleme me kanalet, portat për rregullimin e lëvizjes së ujit, etj. Në këtë mënyrë, ato aktualisht janë jashtë pune, por kapacitetet e tyre janë të konsiderueshme dhe mund të mbulojnë me ujitje gjatë sezonit të verës sipërfaqe të mëdha. Në këte zone takohen mbi dhjetë burime, që dalin në sipërfaqe me një gjatesi 400-450m. Prurja e burimit më të madh është rreth 550l/sek. Së bashku, të gjithë burimet japin rreth 800l/sek. Krahas tyre dalin dhe shume burime të tjerë të vegjël. Prurja e përgjithëshme e burimit të Selitës, i matur sistematikisht gjatë një periudhe pesë vjeçare (1967-1972) nga Instituti i Hidrometeorologjisë rezulton 400l/sek (në tetor) deri në 1080 l/sek (në prill). Karakteristika e këtyre burimeve është temperatura e lartë (14-15 gradë). Temperatura e lartë e burimeve të Selitës, nga disa autorë mendohet, që vjen nga lidhja hidraulike e këtyre burimeve, neujtrat sipërfaqësorë. Temperatura e lartë (14-15o) të ujit, të këtyre burimeve (në raport me burimet e tjera karstike të vendit) mendohet se situata gjeologjike, në rajonin e Dajtit është mjaft e ndërlikuar, ku gëlqerorët e eocenit kontaktojnë tektonikisht në perendim me një seri mergelore paleogenike (pjesa e facies paleogenike të zones Jonike). Prishja tektonike bie në lindje me kend 35-400. Fakti, që burimet e Selitës janë me temperatura të larta (14-15o) dëshmon se kemi të bëjmë me ujra ngjitës, që mesa duket vijnë nga thellësia, të pakten 500m, duke marrë parasysh një mesatare ngrohje prej 1 grade për 33m

thellësi, (gradienti gjeotermik). Prurja e madhe e burimeve karstike të Selitës, që drenojnë gjatë prishjes tektonike (700-1000 l/sek), mendojmë se si zonë ushqimi i tyre është masivi i gëlqerorëve të Dajtit, i cili ka permasa të konsiderueshme, duke marrë parasysh, veç daljes së tij në sipërfaqe dhe vazhdimësinë e tij, nën depozitimet kodrinore.

Si konkluzion, mund të themi se, në lëkundjet e prurjeve së burimeve të Selitës, ruajmë karakteristikat e një burimi tipi karstik, njëlloj si burimet e tjera të vendit.

Cilesite fiziko-kimike te ujit

Uji i burimit të Selitës ka cilësi shumë të mira fiziko-kimike. Ai është pa erë, me shije të mirë dhe transparent. Për vlerësimin e përbërjes kimike, janë marrë prova uji në burimin e tij, të cilat janë analizuar në laboratorin ISHP, ku ka rezultuar, që të gjitha jonet përbërës të jenë brenda normativave të lejuara të ujit të pijshëm. Pra, ka rezultuar cilësi shumë e mirë e ujit, gjë që lejon shishimin e tij për treg. Këshu ka rezultuar:

– Fe 2+3	0.05 mg/l
– Mp	412 mg/l
– Mth	279 mg/l
– Fp	12.88 grade gjermane
– Ph	7.68
– Temperatura	T = 14.5 grade C
– Konduktiviteti	S.p.c. = 0426 ms/cm
– Oksigjeni I lire	Do= 6.57 mg/l
– Ph	7.48
– Kripshmeria salin	0.20 Ps.s TDs = 0.4 gr/l(mineralizimi)
– Oksidoreduktimi	ORP 130 mvdt

Përbërja kimike e ujërave nëntokësore

Jonet kryesore, që përcaktojnë mineralizimin e ujit, janë: Na^+ , Ca^{+2} , Mg^{+2} , Cl^- , SO_4^{-2} , HCO_3^- , CO_3^{-2} . Në sasira më të vogla ndodhen jonet K^+ , Fe^{+2} , NO_3^- , etj.

makroelemente: hidrogjeni, karboni, azoti, oksigjeni, natriumi, kalçiumi, magneziumi, squfuri, kaliumi, bromi, jodi etj. Ato ndodhen të tretura në ujë zakonisht në sasi mbi 10 mg/l.

mikroelemente: litiumi, bori, fluori, alumini, bakri, siliciumi, fosfori, zinku, vanadi, arseniku, kromi, kobalti, nikeli etj. Ato ndodhen në ujëra zakonisht në sasira shumë të vogla nga 10 deri 0.01 mg/l. Në kushte të caktuara gjeologjike disa prej tyre mund të ndodhen në sasira të mëdha;

ultraelemente: rubini, ari, zhiva etj. Ato takohen shumë rrallë në ujëra në sasira jashtëzakonisht të vogla. (nën 0.01 mg/l)

elemente radioaktive: radiumi, tori, radoni, toroni, aktini. Përbërja kimike e ujërave nëntokësore varet nga shumë faktorë si: përbërja litologjike e mjedisit ujëmbajtës, thellësia e shtrirjes së ujërave nëntokësore, sipërfaqja e kontaktit të ujit me shkëmbinjtë, gjatësia e rrugës që bën uji gjatë endjes së tij në nëtokë, lidhja e ujërave nëntokësore me sipërfaqen e tokës, etj. Të gjitha molekulat e kripërave të tretura në ujë disjocohen në jonë pozitive (katione) dhe në jone negative (anione) Kationet, sipas alkalinitetit të tyre ndahen në katione të forta (K^+ , Na^+ ,

NH₄⁺), të dobëta (Ca⁺², Mg⁺²) dhe shumë të dobëta (kationet e metaleve të rëndë). Anionet, sipas (NO₃⁻, Cl⁻, Br⁻, J⁻, SO₄⁻²) dhe të dobëta (HCO₃, CO₃⁻², dhe acidet organike).

Joni i natriumit është shumë i përhapur në ujërat nëntokësore. Në përqëndrime më të larta ai ndodhet në ujërat e kripura, gjë që shpjegohet me tretshmërinë e madhe të këtij joni në ujë. Ky jon në ujë shoqëron më shpesh klorin. Burimet e natriumit në ujë janë: tretja e kripërave NaCl, tjetërsimi i mineraleve të alumino-silikateve të natriumit (albiti), intruzioni i ujërave të detit etj.

Joni i kalçiumit është shumë i përhapur në ujërat nëntokësore, sidomos në ujërat jo shumë të thella. Ai vjen në ujë nga tretja e gëlqerorëve.

Joni i magneziumit është më pak i përhapur se joni i kalçiumit, për shkak se kripërat e tij, megjithë tretshmërinë më të madhe në ujë kanë përhapje më të vogël.

Joni i kalimit është gjithashtu i pranishëm në ujërat nëntokësore, por në sasira të vogla. Nga ana sasiore shoqëron gjithmonë jonin e natriumit në raport 1:14.

Joni i hekurit ndodhet kryesisht në ujëra në sasira të vogla. Ky jon hyn në ujë nëpërmjet oksidimit të mineraleve, që përmbajnë hekur (biotit, amfibol, olivin, pirit). Përmbajtja e lartë e hekurit në ujë (në sasi mbi 0.3 mg/l) favorizon zhvillimin e bakterieve.

Joni i klorit është midis anioneve më të përhapura në ujërat nëntokësore.

Joni i sulfatëve është karakteristik për ujërat e cekta nëntokësore. Ai shoqëron gjithmonë jonin kalçium dhe më rrallë jonin magnezium. Burimi i këtij joni në ujëra është tretja e shkëmbinjve, sulfatike si, gipsi, anhidriti.

Joni i hidrokarbonatëve dhe i karbonatëve, shoqërojnë jonet kalçium dhe magnezium dhe më rrallë jonet natrium dhe hekur. Burimet më të përhapura të këtyre joneve janë: tjetërsimi i mineraleve silikat dhe tretja e gëlqerorëve dhe e dolomiteve.

Lidhjet e azotit (amoniaku NH₃, nitritet NO⁻², nitratet NO₃⁻) ndodhen në ujërat nëntokësore në sasira shumë të vogla. Përqëndrimet më të mëdha të këtyre lidhjeve i takojmë në ujërat e cekëta të përziera me ujërat e zeza. Raporti midis amoniakut, nitriteve dhe nitrateve në ujë është një nga treguesit kryesorë të papastërtisë së tij. Prania në ujë e amoniakut dhe mungesa e nitriteve dëshmon për ndotjen e freskët të ujit nga një burim i afërt ndotjeje.

Mbetjet e thata, të shprehura në miligram për litër, shprehin të gjitha kripërat e tretura në ujë. Ato përftohen nga avullimi i kampionit të ujit në temperaturën 105° C.

Fortësia e ujit, përcakton përmbajtjen e përgjithshme të kripërave të kalçiumit dhe të magneziumit të tretura në 1 litër ujë. Uji i fortë le sediment në enë si në të ftohtë ashtu edhe pas vlimit të tij. Uji me fortësi nën 4° gjermane është shumë i butë, 4°-8° gjermane i butë, 8°-18° gjermane me fortësi mesatare, 18°-30° gjermane i fortë dhe mbi 30° shumë i fortë.

Fortësia e ujit ka rëndësi të madhe praktike. Uji i fortë është i papërshtatëshëm për përdorim të disa degëve të industrisë ushqimore, të letrës etj), pasi gjatë vlimit të tij në kazanet formohet guri i kazanit që zvogëlon së tepërmi përçueshmërinë termike dhe çon në djegien dhe korrodimin e kazaneve. Uji i pijshëm është i mirë kur ka fortësi 8°-12° gjermane.

QUALITY MANAGEMENT SYSTEM



ALBQUALITY
CERTIFICATION

CERTIFICATE

AQ N° 170/15

Il Sistema di Gestione per la qualità di
The Quality Management System of
Sistemi i Manaxhimit të Cilësisë së

RIS shpk

Adresa: Qesarak, Komuna Linze
Tirane , Albania

è conforme alla norma
is in compliance with the standard
është në përputhje me standartin

UNI 10854;99

Linea guida per codex alimentarius e
applicazione dei sistemi

H.A.C.C.P.

per il seguente campo di applicazione
for the following field application
në fushat e mëposhtme të aplikimit

Produzione e commercializzazione di
acqua e di bevande analcoliche.

Prodhim dhe tregetim i ujit dhe i pijeve
freskuese.

EA 03, 29

La validità del Certificato è soggetta al rispetto delle condizioni stabilite nel Regolamento per la certificazione di ALBQUALITY

The validity of the certificate is subject to respect for the conditions established in the ALBQUALITY Regulation
Vlefshmëria e certifikatës është objekt i respektimit të kushteve të përkrahura në rregulloren e certifikimit të ALBQUALITY

La validità del Certificato è subordinata a sorveglianza periodica ed al riesame completo con periodicità triennale
The validity of the certificate is subordinate to periodic surveillance and to a complete reassessment at 3-year intervals
Vlefshmëria e certifikatës i nënshtrohet mbikqyrjes periodike dhe të kontrollit të plotë çdo 3 vjet.

25 / 07 / 2015

Prima emissione
Data e lëshimit të parë

24 / 07 / 2018

Scadenza
Data e skadimit

Lead Auditor:

Dr. Ing. Patrick Olivieri



For certification body

Via Andrea del Castagno No 2, 20139, Milano, Italy, Blv. "Gjergj Fishta", Tiranë Albania, www.albquality.com



REPUBLIKA E SHQIPËRIE
 MINISTRIA E BUJQËSISË,
 ZHVILLIMIT RURAL DHE ADMINISTRIMIT TE UJRAVE
 AUTORITETI KOMBËTAR I USHQIMIT
 DREJTORIA RAJONALE TIRANË

ADRESA: Rr.Hamdi Pepa/ Selite

E-mail: info@aku.gov.al
 Faqe zyrtare www.aku.gov.al

Tiranë më 01.02.2016

RAPORTI I PROVES :182	
Numri Identifikues i Mostres: 182	Data e pranimit: 25.01.2017

Subjekti qe ka Kerkuar Proven/Adresa: TRIS / QESARAKE / TIRANE
 Enti/personi fizik: ISUF BALOSHI Motivi i kampionimit: autokontroll

Fleta Shoqerimit: Nr.010458 Kushtet e Ruajtjes: Ambjent
 Emertimi i Produktit: Uje mineral natyral oligo Data e kampionimit: 25.01.2017
 TIRANA

Data e skadences 30.12.2017: Njesi mostre: 2NJESI

Laboratori i Kryerjes se Proves: Laboratori fiziko-kimik

Pamja e jashtme: Mostër e ambalazhuar ne bidona Plastike 6 L,

Dokumenti financiar: Mandat arkëtimi Nr 56 dt 25.01.2017

Te dhenat per identifikimin e kampionit rezultojne ne dokumentat shoqeruese, etikete ose ne deklaraten e leshuar nga subjekti.

Kampionimi është nën përgjegjësinë e plotë të entit/klientit dhe Laboratori nuk mban përgjegjësi për të.
 Data e Fillimit te Proves: 30.01.2017 Data e Mbarimit te Proves: 31.01.2017

REZULTATI I PROVAVE

TREGUESIT ORGANO – SHQISORE

Pamja: Leng i kthjellët pa turbullirë e pa lende te huaja.

Ngjyra: Pa ngjyre.

Aroma: Pa aroma dhe ere te huaj

Shija: Pa shije te huaja

TREGUESIT FIZIKO-KIMIK	Njesia e matjes	Rezultati	Normat* maksimale
Mbetje e thate e pergjithshme	mg/l	197.5	1000
Fortesia ne grade Gjermane	°GJ	8.1	20
PH		7.03	9.5
Kalcium	mg/l	50	200
Magnezi	mg/l	3.6	50
HCO ₃	mg/l	148.5	

* Normat i referohen standartit shtetror 3904/97

Analisti
 Laureta Aliaj



Pergjegjesi Sektori
 Flutura Vuçini

Ky Raport Prove i përshkruan rezultatet e analizave dhe është prone e AKU.
 Riprodhimi i mund të bëhet vetëm nëse është miratuar nga min e Laboratorit.

FUND RAPORT PROVE



REPUBLIKA E SHqipëRIE
**MINISTRIA E BUJQËSISË,
 ZHVILLIMIT RURAL DHE ADMINISTRIMIT TE UJRAVE**
AUTORITETI KOMBËTAR I USHQIMIT
DREJTORIA RAJONALE TIRANË

ADRESA: Rr.Hamdi Pepa/ Selite

E-mail:info@aku.gov.al
 Faqe zyrtare www.aku.gov.al

Tiranë më01.02.2016

RAPORTI I PROVES :181	
Numri Identifikues i Mostres: 181	Data e pranimit: 25.01.2017

Subjekti qe ka Kerkuar Proven/Adresa: TRIS / QESARAKE / TIRANE
 Enti/personi fizik: ISUF BALOSHI Motivi i kampionimit: autokontroll

Fleta Shoqerimit: Nr.010458 Kushtet e Ruajtjes: Ambjent
 Emertimi i Produktit: Uje mineral natyral oligo Data e kampionimit: 25.01.2017
 TIRANA

Data e skadences 30.12.2017: Njesi mostre: 2NJESI

Laboratori i Kryerjes se Proves: Laboratori fiziko-kimik

Pamja e jashtme: Mostër e ambalazhuar ne shishe plastike 10 L,

Dokumenti financiar: Mandat arkëtimi Nr 56 dt 25.01.2017

Te dhenat per identifikimin e kampionit rezultojne ne dokumentat shoqeruese, etikete ose ne deklaraten e leshuar nga subjekti.

Kampionimi është nën përgjegjësinë e plotë të entit/klientit dhe Laboratori nuk mban përgjegjësi për të.
 Data e Fillimit te Proves:30.01.2017 Data e Mbarimit te Proves: 31.01.2017

REZULTATI I PROVAVE

TREGUESIT ORGANO – SHQISORE

Pamja: Leng i kthjellët pa turbullire e pa lende te huaja.

Ngjyra: Pa ngjyre.

Aroma: Pa aroma dhe ere te huaj


Shija: Pa shije te huaja

TREGUESIT FIZIKO-KIMIK	Njesia e matjes	Rezultati	Normat*maksimale
Mbetje e thate e pergjithshme	mg/l	197.5	1000
Fortesia ne grade Gjermane	°GJ	8.1	20
PH		7.03	9.5
Kalcium	mg/l	50	200
Magnezi	mg/l	3.6	50
HCO ₃	mg/l	148.5	

* Normat i referohen standartit shtetror 3904/97

Analisti
 Laureta Aliaj

Drejtori
 Armand Uruçi



Pergjegjes Sektori
 Flutura Yucini

Ky Raport Prove i perket vetem mostres se analizuar dhe eshte prone e AKU.
 Riprodhimi i mundshem i tij duhet te kryhet vetem me autorizimin e Laboratorit.



Mr. Prot. 1067
Dt. 27.05.2016.

Nr. serisë 0001074

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E SHËNDETËSISË
INSPEKTORATI SHTETËROR SHËNDETËSOR
Dega Rajonale Qarku Tiranë

Inspektorati Shtetëror Shëndetësor, datë 18/05/2016.

Mandat Arkëtimi Nr. - datë 16/05/2016.

000041904689

AKT-MIRATIM HIGJIENO-SANITAR Nr. 1067.

Në zbatim të Nenit 12 të Ligjit Nr.7643, dt.02.12.1992 "Për Inspektimin Sanitar", i ndryshuar, subjektit:

1. Person fizik: _____
(emër/atësi/mbiemër i personit fizik)

2. Person juridik Z. Yusuf Balaski Sh.p.k "RIS"
(emërtimi i subjektit, emër-mbiemër i administratorit)

Me adresë: Qesarak Rrugë: Llogjit Tiranë

Me aktivitet: Makinë transporti jo frigoriferike, NIPT 461908002 E
(ushqimor) AA 937 LD

Mbas ekspertimit higjieno-sanitar të kryer nga Inspektoriati Shtetëror Shëndetësor i jepet:

AKT-MIRATIM HIGJIENO-SANITAR

- Për miratimin e sheshit të ndërtimit të objektit (adresa) _____

- Për miratimin e projektit ndërtimor, teknologjik, rindërtimin, rikonstruksionin (adresa) _____

- Për vënien në shfrytëzim të objektit (destinacioni) Makinë transporti
B. Merc. AA 937 LD

Akt-Miratimi Higjieno-Sanitar nuk lejohet të përdoret për destinacion tjetër. Për çdo ndryshim në projekt/objekt, etj., Akt-Miratimi përsëritet.

Mosmarrja e akt-miratimit prej organeve të Inspektoratit Shtetëror Shëndetësor, për ndërtimin dhe funksionimin e objektit përbën kundërvajtje administrative e dënueshme me gjobë (ligji nr. 7643, dt. 02.12.1992 "Për Inspektimin Sanitar", i ndryshuar, neni 26, pika 14 dhe neni 27).

Bajram Sejgo
Inspektori Shtetëror Shëndetësor

KRYEINSPEKTORI



"ALEX 99" sh.p.k

Haxhi ALIKO
Administrator
Specialist Higjene
+355 68 20 72 300

Zyrë Shërbimesh Dizinfektimi
3D EZINFEKTIM
EZINSEKTIM
ERATIZIM

Adresa: Rr. Ndre Mjeda,
pallati firmës Lura Nr.2,
Tiranë Albania
Tel./Fax: +355 4 225 85 86
Mob.: +355 66 20 72 300
www.alex99-al.com
E-mail: alex99@albmail.com

"ALEX 99" sh.p.k

Dr.Prof. Shaban KAMBERI
Higjenist
+355 67 22 21 778

Zyrë Shërbimesh Dizinfektimi
3D EZINFEKTIM
EZINSEKTIM
ERATIZIM

Adresa: Rr. Ndre Mjeda,
pallati firmës Lura Nr.2,
Tiranë Albania
Tel./Fax: +355 4 225 85 86
Mob.: +355 68 20 72 300
www.alex99-al.com
E-mail: alex99@albmail.com

Subjekti AKUMULIM ALEX 99 SHPK

1. Person fizik: Jo (emri-mbiemri i personit fizik) ose
2. Person juridik: Jo (emërtimi i subjekti/institucionit)

Me NIPT: K415120230

Me objekt në adresë: Burgos Ndre Mjeda Pall Lura 2, Tiranë

Tel/ cel: 0682072300

DËSHMI SHËRBIMI PËR-KONTROLLIN E VEKTORËVE

Vërtetoime se pranë subjektit (Pronari, objekti, adresa) R. S. SHPK, Qesarak, Bayte, Tiranë

U konstatua prezencë insektëve të llojit Jo, Shërbimi Pesticid

Ose minjre Jo, Shërbimi dhe u realizua shërbimi i (dezinfektimit, dezinfestimit, deratizimit) Jo, Pesticid

Në datë 09/09/2017

Lënda pesticide e përdorur Koflunite, Magic I.D.F.G, Podox Bellak, Strace Ngj'uese

Rezultatet pas kontrollit: Shumë të mira
Të mira
Të dobëta

Përsëritja e trajtimit nese eshte e nevojshme: dt. 09/09/2017

Vërtetojmë se në mjediset e objektit nuk konstatohen insekte apo brejtës dhe situata është nën kontroll Jo

Haxhi Aliko
Punëtori Dezinfektues

Dr. Shaban Kamberi
Higjenist
Shoqëria ALEX 99 Shpk
Drejtuasi Teknik
(mjek, biolog, kimist)

Solida Bekoshi

REPUBLIKA E SHqipëRIE
IMPOSTA E VETËDORITISE
"ALEX 99"
SHPK

Dëshmia e shërbimit për kontrollin e vektorëve, plotësohet nga Subjekti e licensuar për aplikim të lëndëve DDD dhe i bëhet administratorit të objektit pas kryerjes së dezinfektimit me rezultatet para dhe pas trajtimit të përsëritur.
Kjo dëshmi përpilohet në tre kopje një kopje e mban administratori i objektit, një kopje e mban subjekti aplikues i shërbimit dhe një kopje dorëzohet në Drejtorinë e Shëndetit Publik të rrethit.



INSTITUTI I SHËNDËTTI PUBLIK

REPUBLIKA E SHqipëRISE
MINISTRIA E SHËNDËTTËSISË

Adresa: Shoq. ALEX 99 sh.p.k
Rruga: "Myslym Shyri" Nr.120
Ngjitur shkollës, "Dorë d'Istria"
http://www.alex99-al.com
E-mail: alex99@albmail.com
Tel./Fax.: +355 (4) 224 16 118 / Tel. Tring 044 80 60 32
Mob.: +355 68 20 72 300

Shërbimi 3DDD = Dezinfektim- Dezinfektim- Deratizim (Publik Privat)

Adresa: Magazina ish S.M.T, Qyteti i Nxënësve Tiranë
Nr. Liçensës 5038 (e rinovuar), lëshuar nga QKL (Qendra Kombëtare e Liçensimit) Tiranë
Nr. NIPTI K415120230 lëshuar nga Organi Tatimor Tiranë.

CERTIFIKATE SHERBIMI

E lëshuar më datë 09/03/2017, në objektin institucionin
R. I. S., Shtëpi, Qesarak, Dajti, Tiranë

1. Në datën e sipërsëhënuar u krye:

- a- Inspektimi
- b- Dezinfektimi
- c- Dezinfektimi
- d- Deratizimi

2. Sipërfaqja e trajtuar m^2 2000, m.linear 350, ose 50 Cap Stice

- a- u bë dezinfektimi i dhomave dhe detyrat e gjatë dhe të shkurtra
- b- te erudierëve dhe te jashtë të firmës R. I. S.
- c- u vendosën shtatë kartica me përbërës të erudierëve
- d- u bë deratizimi jashtë dhe i vendosur i lloj kartice Plartel

3. Lloji i preparatit të përdorur (helm): K - ofurim, Mugis 10 EC
Rodex Wax Bellaks Stice kartica Ngjësora Moudhijant

-Sasia e përdorur 25kg+2lit+4kg+50 Cap përqendrimi (%) 0.2 (Zero gly)

-Orë ekspozimi 3+3=6 Gjallite të firmës ALEX 99 Sigur të punës

4. Detyrat të lëna Ajrona dhe të lëhet dhe papur dyet dhe aplikohet
20 minuta para punës. Tani duat para punës dhe para

5. Inspektimi vërteton se masat e marra janë në përputhje me rregullat në fuqi urbane.

Përfaqësues i objektit, institucionit
(Emri, mbiemri, nënshkrimi)

Solal Basha

Kastur Alila

Emri, mbiemri i specialistit

(Nënshkrimi) **KAMBERI**
HIGJENIST
Shoqëria ALEX 99 Shpk



REPUBLIKA E SHQIPERISE
MINISTRIA E SHENDETESISE

ALEX 99 Shtëpi

Sherbimi Dezinsektim-Deratizimit DDD (Publik Privat)

Adresa: Hy. S.M.T. Qyteti Mënyeve Tiranë
Nr. Tel. 0682072300, Nr. Licenses 3231/D/27/4/2007

ÇERTIFIKATE SHERBIMI

E lëshuar me date 25/02/2012, ne objektin, institucionin
Firma "RIS" Shtëpi, Qesarak, Tiranë

1. Ne datën e sipershenuar u krye :

- a- Inspektimi
- b- Dezinsektimi (nenvizo)
- c- Deratizimi koncentrimi kutite plastike Mautarimit (Brystat)

2. Siperfaqja e trajtuar 8. katë m² (ne total) ose m.linear → 2000 m²
ne lokalet (sheno vendin) :

- a- U të dendelotimi i gjelër analizimit të Firmës "RIS"
- b- Zyra, Salla e Mbledhjes, Muzgahana, Tualeti (WC), Teritori jashtë
- c-
- d- U të dhe deratizimi i murit rrotures dhe rreth analizimit.

3. Lloji i preparatit te perdorur (helm) :

Aptel Forte, Kaolin dhe Glodacid (ne faze katere)

- Sasia e perdorur 1 kg perqendrimi (%) 0,2
- Ore ekspozimi 2 dj

4- Detyra te lena Ajrande dhe te lulet diten e bene duhe hapur

dyet para punës 30 minuta dhe ne pas te lulet pastaj me

Punajent te mas ngacemajent kate e Brystatave te maotari mit,

5-Inspektimi verteton se masat e marra jane ne perputhje me rregullat ne fuqi.

Punajent te laje duar para punës dhe para konsumimit te ushqimit.

Perfaqesues i objektit, institucionit
(Emri, mbiemri, nenshkrimi)

Emri, mbiemri i specialistit
(Nenshkrimi)

Selma Basha

Halili Alilo
VULA

[Signature]

[Signature]

**Subjekti/Shërbimi për Kontrollin e Vektorëve i Liçensuar
(dezinfektim, dezinfektim, deratizim)**

Subjekti Privat

1. Person fizik: Jo

(emri-mbiemri i personit fizik)

2. Person juridik: PO ALEX 99 SHPK ose

(emërtimi i subjektit/institucionit)

Me NIPT: K415120230

Me objekt në adresë: Ull. S.M.T. Qyteti Kuvener Tiranë

Tel/ cel: 0682072300

DËSHMI SHËRBIMI PËR KONTROLLIN E VEKTORËVE

Vërtetojme se pranë subjektit (Pronari, objekti, adresa)

Firma "RIS" SHPK, Qesarak, Tiranë

U konstatua prezencë e insekteve të llojit Jo Shërbimi Mjekësues
Ose minjve Jo kontroll dhe u realizua shërbimi i (dezinfektimit,
dezinfestimit, deratizimit) PO RUTINE

Në datë 25/02/2012

Lënda pesticide e përdorur Cyral Fark, kaotulic, Glodacid.

- Rezultatet pas kontrollit:
- Shumë të mira
 - Të mira
 - Të dobëta

Përsëritja e trajtimit nese eshte e nevojshme: dt. 16/03/2012

Vërtetojmë se në mjediset e objektit nuk konstatohen insekte apo brejtës dhe se situata është nën kontroll. PO

Punëtori Dezinfektues
Adriatik Spahiu

Drejtuesi Teknik
(mjek, biolog, kimist)

[Signature]
[Signature]

[Signature]
[Signature]

Dëshmia e shërbimit për kontrollin e vektorëve, plotësohet nga Subjektet e licensuar për aplikim të lëndëve DDD dhe i lihet administratorit të objektit pas kryerjes së dezinfektimit me rezultatet para dhe pas trajtimit të përsëritur.
Kjo dëshmi përpilohet në tre kopje një kopje e mban administratori i objektit, një kopje e mbanë subjekti aplikues i shërbimit dhe një kopje dorëzohet në Drejtorinë e Shëndetit Publik të rrethit.



REPUBLIKA E SHQIPËRIE

MINISTRIA E BUJQËSISË ZHVILLIMIT
RURAL DHE ADMINISTRIMIT TË
UJËRAVE AUTORITETI KOMBETARE I
USHQIMIT DREJTORIJA RAJONALE
QARKU TIRANE

Nr. 12/2 Prot.
1/2

Tiranë, më 20/21/2014

Notifikim ETIKETE

Emri i Produktit: Ujë Tirana 2 litra

Emri i subjektit: "RIS" sh.p.k.

Perfaqësuesi i Subjektit

Isuf Baloshi



IV. INFORMACION LIDHUR ME IDENTIFIKIMIN E NDIKIMEVE TË MUNDSHME

4.1. NDIKIMI NË MJEDIS DHE NË VEPRAT PËRRETH

Për të analizuar ndikimet të mundshme në mjedis janë vlerësuar burimet dhe shkaqet e këtyre ndikimeve të mundshme. Funkcionimi i kësaj fabrike do t'i japë munsësi komunitetit dhe klienteve të konsumojnë uje te ambalazhuar me cilesi dhe standarte sipas Institutit te Higjenes, si dhe do zhvillojë në mënyrë të ndjeshme biznesin privat. Burimni i Selite dhe ShenMarise është pasuri natyrore jashtëzakonisht e madhe, por imbutilimi dhe ambalazhimi i tij, për konsum të gjerë do siguronin një vlerë të shtuar të konsiderueshme për gjithë rajonin.

4.2 NDIKIMET POZITIVE

Sipas studimit të deritanishëm, nuk është identifikuar asnjë “ndikim negativ fatal”, por ekzistojnë vetëm ndikime pozitive, të cilat do të zhvillojnë kete zone, si dhe do kontrollohen disa masa zbutëse organizative për të shmangur ndonjë ndikim negativ rastesor nga ato të lidhura me aksidentet njerëzore. Edhe pse është e pa evitueshme, që në rajon të shfaqen disa ndikime negative mjedisore, projekti do të bëjë që:

- të ketë punësim të vazhdueshëm;
- të sigurojë investime të drejtpërdrejta në komunitetin lokal;
- të krijojë të ardhura të konsiderueshme financiare dhe ekonomike në rajonin në tërësi;
- ndikimet mjedisore që identifikohen të eliminohen, reduktohen ose zbuten.

Tabelë përmbledhëse e ndikimeve pozitive, që do të gjenerohen nga funksionimi i fabrikes se ujit

Burimi i Ndikimeve	Objekti mbi të cilin bien	Lloji i ndikimit
Mjedisi per komunitetin	Banorët vendas Biznesin vendas	+++ , punesim të banoreve te zones; +++;zhvillim të biznesit vendas;
Tregetimi i ujit te pijshem te ambalazhuar për komunitetin	Banorët vendas	+++ ,Garantimi i ujit te pijshem te ambalazhuar, të shëndetëshme dhe të sigurtë për konsumatorët.
Zhvillimi i tregëtisë se ujit	Ekonomia e komunitetit	+ + ,ulja e efekteve të papunësisë së zonës + + ,përmirësimi i jetesës së banorëve të zonës
Shfrytëzimi i fuqisë punëtore.	humane	+++ , Rritja e punësimit në komunitet.
Rritja e aksesit te zonës (për përdorim-shfrytëzim, rikrijim)	Mjediset humane	+ + + , konsiderohet si mjaft positive.
Ngjeshja e tokës pas mbarimit	Tokë, ujra	++ , Rruajtja e topografis së zonës dhe shmangien e erozionit ujqor;
Punime për sistemim të shesheve.	Peisazh	+++ , kthimi në gjendjen e mepareshme.

Shpjegim :

- , Ndikim negativ i konsiderueshëm
- - , Ndikim negativ i lartë
- - - , Ndikim negativ shumë i lartë
- ? , Ndikim negativ që mund të mos ndodhë, por që duhet marrë në konsideratë.
- + , Ndikim pozitiv
- + + , Ndikim pozitiv i konsiderueshëm
- +++ , Ndikim pozitiv shumë i lartë.

Ky aktivitet ka një fokusim të gjerë në rritjen e ndikimeve pozitive gjatë zbatimit të këtij projekti. Në bazë të kësaj tablele nxirret përfundimi, se funksionimi i kesaj fabrike në tërësi

përbën një hap pozitiv. Kryerja e këtyre punimeve, duke patur parasysh efektet mjedisore do të ndihmonin në klasifikimin e këtij investimi, ndër objektet me ndikime pozitive në mjediset humane, duke përmirësuar ndjeshëm ekonominë lokale.

Projekti i funksionimit të fabrikës së prodhimit dhe ambalazhimit të ujit, si dhe e prodhimit të pijeve jo alkolike, paraqet një sërë parametrash për t'u marrë si shembull pozitiv dhe që ia vlen t'i theksosh e t'i zbatosh në zona apo komuna të tjera, duke i hapur rrugë zhvillimit të qëndrueshëm dhe jo atij apriori.

Fazat	Përfitime të drejtpërdrejta të komunitetit	Përfitime të tërthorta të komunitetit.	Konsumatori	Infrastruktura
Ndërtim i fabrikës së prodhimit dhe ambalazhimit të ujit	Mundesia zhvillimi të biznesit në zonë	Zbutja e papunësisë dhe përmirësimi i standartit të jetesës	Garantimi dhe sigurimi i ujit të pijshëm në standarte dhe cilësi të garantuara	Plotësimi me infrastrukturë urbane.

Duke patur parasysh vlerat e mëdha të territorit në gjëndjen aktuale, mendohet se kompensimet dhe ndikimet e tjera pozitive, si punësimet, përmirësimet në infrastrukturë marrin një rëndësi të veçantë për komunitetin. Këto ndikime nxisin edhe komunitetin për mbështetjen e investimeve.

Ngritja e pikave të grumbullimit të përpunimit të produkteve

Fabrika ka nevojë për të patur pikat e veta të grumbullimit, si dhe vende të ruajtjes së prodhimit. Në këto pika, ajo nuk duhet të merret thjesht me tregtimin e produktit por edhe me grumbullimin e mbetjeve të produktit, si rezultat i marrëveshjeve që mund të nënshkruaj me tregtarët.

Ngritja e kapaciteteve prodhuese

Kjo ka të bëjë kryesisht me trajnimin, shkëmbimin e eksperiencave dhe mbajtjen në kontakt me të rejat bashkëkohore për zhvillimin rural dhe më gjerë. Niveli i stafit të fabrikës, stafi menaxherial i tyre, kanë një rol të madh në mbarëvajtjen e gjithë jetës së këtij aktiviteti në këtë zonë. Nga ana tjetër, ky nivel i tyre ndikon edhe në qëndrueshmërinë e investimeve që janë kryer dhe mund të kryhen në këtë zonë në të ardhmen. Për këtë arsye është e nevojshme që të gjenden rrugët edhe mundësitë, që të bëhet e mundur kryerja e trajnimeve të ndryshme.

4.3. NDIKIMI NË MJEDIS GJATË FUNKSIONIMIT TË FABRIKES SË UJIT

Ky aktivitet nuk shoqerohet me ndotje, si nga pluhuri i mjeteve për ngarkesat gjatë qarkullimit të automjeteve, ashtu edhe nga rritja e lëvizjes së mjeteve të motorizuara.

Ndikimi negativ në ujëra sipërfaqesore

Aktiviteti nuk përdor dhe nuk shkarkon ujëra që të ketë ndikime negative në sipërfaqe në terren.

Ndikimi negativ në tokë

Aktiviteti nuk do të ketë ndikime negative në tokë sepse nuk do të ketë mbetje të ndryshe që të rrinë të hapërdara në ambejnte jashtë saj.

Ndikimi në reliefin e zonës

Zona që do të funksionojë për furnizimin e fabrikes me ujë të burimit të Selites nuk do të shkaktojë ndryshime në reliefin dhe topografinë e zonës, sepse nuk do të gryhen tokat dhe kjo do të bëjë që sheshi i fabrikes dhe në zonën përreth do të mbetet i njëjtë.

4.4. NDIKIMI NË MJEDIS GJATË SHFRYTËZIMIT TË UJIT TË BURIMIT

Ky është aktiviteti kryesor, që mendohet se ka ndikimet më të mëdha jo vetëm nga pikëpamja e efekteve momentale, por edhe për jetëgjatësinë e saj. Uji i Burimit të Selites merret nëpërmjet një sistemi pompash, grumbullohet në depozita nga ku kalon disa faza pastrimi dhe disinfektim, ai ambalazhohet për konsum si produkt i gatshëm. Uji i pijshëm kontrollohet nga pikëpamja e karakteristikave fizike, kimike e bakteriologjike. Objektivi themelor i këtij aktiviteti është shfrytëzimi i ujit të pijshëm në mënyrë që ai të shërbejë realisht për promocionin e shëndetit publik. Brënda këtij objektivi, do të zbatohen kërkesat sanitare të domosdoshme për sigurimin e pastërtisë së ujrave të pijshëm të konfirmuar nga Organizata Botërore e Shëndetit (OBSH).

Tabela e ndikimeve që do të gjenerohen nga shfrytëzimi i ujit të burimit të Selites

Burimi i Ndikimeve	Objekti mbi të cilin bien	Lloji i ndikimit
Zhvillimi i industrisë së prodhimit të ujit të pijshëm në vend	Ekonomia e komunitetit	+ +, ulja e efekteve të papunësisë së zonës + +, përmirësimi i jetesës së banorëve të zonës.
Shfrytëzimi i burimit natyror të ujit të pijshëm në vend.	humane	+++ , Rritja e punësimit në komunitet.
Rritja e aksesit me zonën (për përdorim-shfrytëzim, rikrijim)	Mjediset humane	+ + + , konsiderohet si mjaft positive.

Shpjegim :

- , Ndikim negativ i konsiderueshëm
- - , Ndikim negativ i lartë
- - - , Ndikim negativ shumë i lartë
- ? , Ndikim negativ që mund të mos ndodhë, por që duhet marrë në konsideratë.
- + , Ndikim pozitiv
- + + , Ndikim pozitiv i konsiderueshëm
- + + + , Ndikim pozitiv shumë i lartë.

Ky aktivitet kërkon një fokusim të gjerë për rritjen e ndikimeve positive, jo vetëm në fazat gjatë shfrytëzimit por edhe më pas, në periudhën e rehabilitimit e pas saj.

Tabela: Vlerësimi i ndikimeve negative më të rëndësishme në mjedis

1. Lloji i ndikimit	2. Faza e punimeve të fillimit të fabrikes	3. Faza e funksionimit të fabrikës
Ndikime në topografinë e territorit	aspak	aspak
Shqetësimet në agrokultura	aspak	aspak
Dëmtim i habitateve ujore	Të lehta	aspak
Varfërimi i shtresës sipërfaqësore nga biomasa	aspak	aspak
Shqetësimet nga mbeturina personale të punonjësve	Të lehta	aspak

4.5. NDIKIMI NË MJEDIS NGA PUNIMEVE E SISTEMIMIT TË FABRIKES

Duke pasur parasysh kohën e shkrutës të punimeve të sistemimit të fabrikes, mendohet që çlirimi i mundshëm i pluhurave nuk do të ketë ndonjë efekt të madh mjedisor dhe efektet, do të jenë lokale dhe të përqendruar pranë fabrikes deri në momentin e perfundimit të kësaj përgatitje për fillimin e funksionimit të fabrikes, pra do të jenë me karakter të përkohshëm.

Tabelë përmbledhëse e ndikimit në ndotjen e ajrit nga mbetjet

Burimi i Ndikimeve	Objekti mbi të cilin bien	Lloji i ndikimit
sistemimi i sheshit të zonës rreth fabrikes	Ajër. Punonjësit	- , ndotje minimale e ajrit nga gjenerimi i pluhurave.

Aksidente të mundshme gjatë procesit të sistemimit të sheshit rreth fabrikës	Punonjësit,	- , Rritja e mundësisë për aksidente.
Gjenerimi i mbeturinave	Mjediset urbanë	+, menaxhimi rigoroz i tyre
Gjenerimi i mbeturinave personale	Punonjësit	++, Mbetjet personale te punonjësve do menaxhohen merigorozitet.

Shpjegim:

- , Ndikim negativ i konsiderueshëm
- , Ndikim negativ i lartë
- , Ndikim negativ shumë i lartë
- ?, Ndikim negativ që mund të mos ndodhë, por që duhet marrë në konsideratë.
- +, Ndikim pozitiv
- ++, Ndikim pozitiv i konsiderueshëm
- +++ , Ndikim pozitiv shumë i lartë.

Ndikimi në zhurma

Ndikimet lokale në rritje të niveleve të zhurmës parashikohen të kenë ndikim negative në cilesinë e jetës për punëtorët të zonës. Oraret e punës do të kufizohen në përputhje me standartet kombetare. Me zhurmat janë të lidhura dhe shqetësimet nervore, streset dhe pagjumësia. Zhurmat mund të shkaktojnë çrregullime të gjumit, çrregullime të komunikimit, dëmtime në dëgjim, efekte kardiovaskulare, efekte psikologjike, mërzitje deri në ndryshime të sjelljeve sociale. Ekspozimi për pak kohë në zhurma më shumë se 140dB(A) sjell shurdhim të menjëhershëm. Ndërsa ekspozimi për disa vjetë në zhurma mbi 85 dB(A) sjell një shurdhim gradual. Ekranet akustikë të qarkullimit si dhe përdorimi i materialeve kundra zhurmave në funksionimin e kesaj fabrike, ulin nivelin e dëgjimit të zhurmave nga 5-15dB.

Tabela: Vlerësimi i ndikimeve negative më të rëndësishme në mjediset humane

1.Lloji i ndikimit	2. Faza e punimeve të sistemimit të fabrikës	3. Faza e funksionimit të fabrikës
Shqetësimet nga zhurmat dhe dridhjet gjatë operacioneve të punës	Të lehta	Relativisht të pa rëndësishme
Shqetësimet nga zhurmat gjatë transportit të materialeve	Të lehta	Relativisht të pa rëndësishme

Kjo veprimtari sistemuese do të ketë një kohëzgjatje jo shumë të gjatë falë teknikës dhe teknologjisë së re dhe paisjeve moderne që sot funksionojnë nëpër kantieret e fabrikave. Kështu që vetëm për banorët e zonës do të vihet re prania e mjeteve, zhurmave dhe trafikut, ndërsa për kalimtarët e rastit nuk do të jetë ndonjë bezdi fakti i të qenit të një funksionimi të fabrike ambalazhimi të ujit të pijshëm. Ndikimet negative të sistemimit përfshijnë dëmtimin direkt potencial ndaj florës dhe faunës në këto zonë nga aksidenti i hedhjes apo flakjes së materialit të gërmuar, ndërthurjen e transportit të materialit të gërmuar me trafikun ekzistues, si dhe ndotjen e zhurmën gjatë punës së pajisjeve për pastrim dhe sistemim. Edhe pse ky impakt, në aktivitete të tilla sot konsiderohet i vogël, pasi mbetjet që do të grumbullohen do të transportohen menjëherë brenda një periudhe të shkurtër kohe dhe do të depozitohen në vendet e miratuara nga qeverisja lokale. Për më tepër, efekti është i shkrutër dhe kushtet normale do të rikthehen pas periudhës së sistemimit të ambientit rreth fabrikës.

Ndikimi në biodiversitet

Ndikimet negative të shkaktuara në biodiversitet nga dridhjet, pluhurat dhe zhurmat kanë vetëm rrugë reduktimi siç është përcaktuar në uljen e niveleve të tyre për ajrin. Përsa i përket habitateve të fragmentizuara do të merren masat si gjelbërimi përgjate shtrirjes së fabrikës, që do të rrisë sipërfaqet e gjelbëruara, gjë e cila garanton diellzimin e nevojshëm dhe nxitjen e zhvillimit të specieve të tjera spontane. Në këtë mënyrë mund të sigurohet një vazhdimësi natyrore e vegjetacionit në zonat përreth.

Ndikimet në sipërfaqet ujore

Nga punimet e sistemimit të zones rreth fabrikës nuk do të ketë ndikime negative në modelin drenazhues të tokës pasi nuk do të prek sisteme të ndryshme të ndërtuara por do të plotesoje me sistem drenazhimi sipas projektit. Zhvillimi që do të marrë kjo zonë në tërësi nuk do të ndikojë në nivelin e ujrave tokësore, në rrugët ujore dhe në rrjedhën e ujrave nëntokësore.

4.6. VLERËSIMI DHE IDENTIFIKIMI I NDIKIMEVE NEGATIV NË MJEDIS

Funksionimi i aktiviteteve të tilla në këto zona ka veçorinë, që kërkon ngritjen e një infrastrukture të përshtatshme me plane menaxhimi mjedisore gjatë sistemimit edhe nga ana vizuale dhe funksionale si:

- sheshin e objektit, i cili sistemohet dhe drenazhohet nga ujrat sipërfaqesore;
- vlerësimin dhe identifikimin e ndikimeve në mjedis si me poshte:

Vlerësimi i ndikimeve negative e pozitive gjatë funksionimit të verpes

<i>Lloji i ndikimit në tokë</i>	<i>Identifikimi i ndikimit</i>			
	<i>Gjatë sistemimit të fabrikes</i>		<i>Gjatë funksionimit të fabrikes</i>	
	<i>Po</i>	<i>Jo</i>	<i>Po</i>	<i>Jo</i>
Ndryshime topografike të terrenit		x		x
Prishja e tokës bujqësore		x		x
Ndotja e tokës nga rrjedhjet		x		x
Ndotja e tokës nga mbetjet e ngurta		x		x
Ndotja e tokës nga depozitimet e llumrave		x		x

<i>Lloji i ndikimit në cilësinë e ajrit</i>	<i>Identifikimi i ndikimit</i>			
	<i>Gjatë sistemimit të fabrikes</i>		<i>Gjatë funksionimit të fabrikes</i>	
	<i>Po</i>	<i>Jo</i>	<i>Po</i>	<i>Jo</i>
Prodhimi i areosolave		x		x

<i>Lloji i ndikimit në florën dhe faunës</i>	<i>Identifikimi i ndikimit</i>			
	<i>Gjatë sistemimit të fabrikes</i>		<i>Gjatë funksionimit të fabrikes</i>	
	<i>Po</i>	<i>Jo</i>	<i>Po</i>	<i>Jo</i>
Shkatërrimi i rëndësishëm i habitateve natyrore		x		x
Rrezikimi i ndërhyrjes në bimët e ujit		x		x
Ndërtimi i rrugëve të reja që kalojnë përmes zones së virgjër		x		x
Përçarje apo izolim të habitateve të egra		x		x
Interferencë midis rrugës natyrore të emigrimit të sisonëve		x		x

<i>Lloji i ndikimit në ujë</i>	<i>Identifikimi i ndikimit</i>			
	<i>Gjatë sistemimit të fabrikes</i>		<i>Gjatë funksionimit të fabrikes</i>	
	<i>Po</i>	<i>Jo</i>	<i>Po</i>	<i>Jo</i>
Trajtimi i ujrave të ndotur		x		x
Ndotja e ujit prej pluhurit, hidrokarbureve, derdhjeve aksidentale dhe substancave të tjera		x		x
Impakti sekondar në ndotjen e ujit për toka		x		x

bujqësore, ujrat nëntokësore etj.				
Modifikim në drenazhimin e ujrave natyrore		x		x
Ndotja e ujrave sipërfaqësore dhe nëntokësore nga llumrat		x		x
Lloji i ndikimit në ndotjen nga zhurmat	Identifikimi i ndikimit			
	Gjatë sistemimit të fabrikes		Gjatë funksionimit të fabrikes	
	Po	Jo	Po	Jo
Rritja e nivelit ekzistues të zhurmave		x		x
Rritja e nivelit të zhurmave si rezultat i aktivitetit dhe makinave	x			x
Rritja e nivelit të zhurmave për njerëzit	x			x
Niveli më i lartë i zhurmave për kafshët		x		x

Lloji i ndikimit në përfitimin e tokës	Identifikimi i ndikimit			
	Gjatë sistemimit të fabrikes		Gjatë funksionimit të fabrikes	
	Po	Jo	Po	Jo
Shkatërrim banesash		x		x
Ndryshime të rëndësishme në programet për të ardhmen e përdorimit të tokës		x		x
Rivendosje banesash		x		x
Shpronësime të tokës		x		x

Lloji i ndikimit për trashëgiminë kulturore	Identifikimi i ndikimit			
	Gjatë sistemimit të fabrikes		Gjatë funksionimit të fabrikes	
	Po	Jo	Po	Jo
Ndryshime apo dëmtime të zonave arkeologjike apo me vlerë historike e kulturore		x		x

Lloji i ndikimit në energji	Identifikimi i ndikimit			
	Gjatë sistemimit të fabrikes		Gjatë funksionimit të fabrikes	
	Po	Jo	Po	Jo
Përdorim i sasive të mëdha të karburantit për energji		x	x	
Rritje të rëndësishme të kërkesave për burime ekzistuese të energjisë apo kërkesave për tipe të reja të energjisë		x	x	

Lloji i ndikimit në interesin publik (infrastruktura)	Identifikimi i ndikimit			
	Gjatë sistemimit të fabrikes		Gjatë funksionimit të fabrikes	
	Po	Jo	Po	Jo
Ndryshimi i destinacionit të aktivitetit do të ketë apo jo nevojë për ndryshim në këtë fushë të interesit publik		x		x

Energji elektrike		x		x
Sistemin e komunikacionit		x		x
Sistemin e kanalizimit të ujrave të zeza dhe të bardha		x		x
Sistemin e ujësjellësit		x		x
Mbetjet e ngurta dhe depozitimi i tyre		x		x

<i>Lloji i ndikimit në shëndetin publik</i>	<i>Identifikimi i ndikimit</i>			
	<i>Gjatë sistemimit të fabrikes</i>		<i>Gjatë funksionimit të fabrikes</i>	
	<i>Po</i>	<i>Jo</i>	<i>Po</i>	<i>Jo</i>
Krijimi i çfarëdo rreziku apo mundësie për dëmtimin e shëndetit të njerëzve		x		x
Krijimi i raportit të njerëzve me rreziqet e mundëshme për dëmtimin e shëndetit publik		x		x

<i>Lloji i ndikimit në qarkullim dhe transport</i>	<i>Identifikimi i ndikimit</i>			
	<i>Gjatë sistemimit të fabrikes</i>		<i>Gjatë funksionimit të fabrikes</i>	
	<i>Po</i>	<i>Jo</i>	<i>Po</i>	<i>Jo</i>
Shtime të rëndësishme të qarkullimit të automjeteve	x			x
Pakësime të vendqendrimeve të automjeteve apo nevoja për vendqendrim të reja		x		x
Ndikime të rëndësishme në sistemin e komunikacionit		x		x
Ndryshime në qarkullimin apo lëvizjen e njerëzve		x		x

4.7. Vlerësimi dhe identifikimi i Mbrojtjes në punë sipas rregullave të teknikës së sigurimit

Hyrja për në zonat e shërbimit duhet të jetë e rrethuar plotësisht. Gjatë kryerjes së aktiviteteve do të zbatohen me përpikmëri rregullorja e sigurimit teknik. Punimet do të kryhen konform skemës. Para fillimit të punës duhet të kontrollohen frontet e punës në çdo post pune, si dhe kontrolli i gjendjes së çdo paisjeje. Në objekte duhet të vendosen tabelat e sigurimit teknik, mbrojtjes nga zjarri, që kufizojnë punonjësit apo të huajtë për kalimin me vend e pa vend nëpër zonat e ndërtimit, rrugët e detyrueshme të kalimit për ruajtjen nga ndonjë aksident i mundshëm gjatë veprimtarisë operacionale në këto zona. Punonjësit duhet të pajisen me veshje pune dhe të trajnuar në shërbimin e këtij aktiviteti. Duhet të disponohen dokumenta, ku pasqyrohet puna me punonjësit për njohjen dhe zbatimin e rregullave, e cila do të bëhet e përjavshme dhe e dokumentuar me firmat përkatëse për njohuritë bazë në zbatimin e rregullave të sigurimit teknik. Duke u nisur nga problematikat që paraqesin këto produkte, del detyrë parësore zgjedhja e personelit që do të punojnë nëpër objekte.

V. SHKARKIMET E MUNDSHME NË MJEDIS

Si çdo objekt tjetër, që funksionon në një mjedis të caktuar deri në arritjen e formës së caktuar ka një sërë punimesh sistemimi dhe funksionimi. Sistemimi dhe funksionimi i objektit në këtë zonë ka veçorinë, që kërkon ngritjen e një infrastrukture të përshtatshme dhe deri diku komode, si nga ana vizuale dhe funksionale si:

- pastrimin e zones se objektit, i cili sistemohet dhe shtrohet;
- përshtatjen e godinës dhe ambjenteve të kryerjes së aktivitetit.

Ky sistemim do të kryhet në një sipërfaqe kodrinore, ku ky aktivitet në kushte normale kërkon investime të konsiderueshme, dhe e parë në këndvështrimin ndaj mjedisit është një veprim që kryhet në të, por jo për ta keqësuar, por për ta përmirësuar dhe për ta vënë në shërbim të njeriut, jo vetëm për qëllime të ngushta përfitimi, por edhe në interes të zhvillimit ekonomik.



5.1. ÇLIRIME TË PLUHURAVE NGA FUNKSIONIMI I FABRIKËS

Aktiviteti nuk ka të bëjë me prodhimin e gazeve të çfarëdolloj qofshin ato si serë apo dicka tjetër, ndaj Shkarkimi i gazrave në ambientet e kësaj fabrike të ujit nuk do të jete prezente në të. Pjesa më e madhe e mjeteve do të operojnë në shpërndarjen e produktit në ambjent të hapur, ndaj ndikimi në ndotjen e ajrit konsiderohet i papërfillshëm, për shkak të lëvizjes të ulët të makinave të shpërndarjes së mallit.

Ndotja e ajrit nga grimcat e ngurta

Rrugët ndihmëse të ambienteve të fabrikës do të trajtohen vazhdimisht me ujë përpara se të kalojnë automjetet, duke evituar kështu gjenerimin e pluhurave.

Zhurmat dhe dridhjet

Të gjitha pajisjet që lëshojnë zhurmë do të mirëmbahen ashtu siç duhet për të minimizuar ndikimin e zhurmës në rajon. Pajisjet që lëshojnë zhurmë do të jenë sipas standarteve të BE rreth zhurmës së shkaktuar në mjedis. Burimet e vetme të mundshme do të jenë gjeneratorët, por ata do të vendosen në vendet të mbyllura dhe të izoluara. Ndërsa pajisje të tjera të mundshme për zhurmë e vibrime nuk ka. Gjithsesi më poshtë paraqiten nivelet maksimale të zhurmës, që pranohet.

- E vazhdueshme 1.000m nga kompleksi 45dBA;
- E çastit 1.000m nga kompleksi 55dBA;
- Niveli maksimal 1m nga pajisja 85dBA.

Ndotja e ujit

Derdhja e ujërave të larjes së ambienteve të fabrikes, mund të krijojnë kushte për ndikime të ujrave sipërfaqësor. Ndikimi i këtyre faktorëve është "i vogël", duke marrë në konsideratë nivelin e pajisjeve të përfshira dhe standartet.

Mbeturinat

Gjatë periudhës së funksionimit, problemi i prodhimit të mbeturinave do të jetë i parëndësishëm, sepse do të prodhohen mbeturina tepër të vogla nga vetë proceset e punës. Pritet gjithashtu, prodhimi i mbeturinave personale të punëtorëve dhe personelit. Llojet, sasi, data dhe mënyra e largimit të të gjithë mbeturinave të rëndësishme do të shënohet në një regjistër dhe për më tepër puntorëve do t'u kërkohet të mbledhin veç fraksionet e ndryshme të mbeturinave. Këto mbetje do të hidhen në koshat e mbetjeve dhe do të përfundojnë në kontenier të mbetjeve bashkiake.

Trafik i ri shtesë i krijuar

Lëvizjet e kamionëve për dërgimin e materialeve dhe largimin e tyre do të parashikohet që të ndodh në kohën me më pak trafik në rrjetin rrugor lokal, me qëllim që të ndërthuret sa më pak me trafikun normal të zonës suburbane dhe urbane. Kësisoj, do të jetë e udhës, që më mirë lëvizjet të kryhen kryesisht në intervalin kohor 17-07.

Lëkundje, Vibrimet

Lëkundje nuk do të ketë, sepse pajisjet lëvizëse janë shumë të pakta në numër dhe me fuqi të ulët dhe me konstruksione, që garantojnë punë në ekuilibër të plotë. Gjatë aktivitetit nuk do të ketë vibrime.

Nriçimi

Nriçimi që do të përdoret gjatë ditës është drita e diellit, sepse do të punohet vetëm gjatë dites.

Nxehtësi

Nxehtësi nuk do të çlirohet gjatë procesit të punës sepse nuk do të përdoren paisje që çlirojnë nxehtësi, pra nuk do të sjellë ndikim negativ në mjedis, si në ujërat sipërfaqësore dhe ato nëntokësore ose në ajër ose në shëndetin njerëzor.

Shqetësimet estetike

Gjatë shërbimeve, ka operacione, si ngarkim-shkarkim, lëvizja e materialeve, për të cilat nuk pritët të rezultojnë në ndonjë shqetësim të dukshëm estetik.

Cënimi i interesave publike ose private

Ndërtimet e propozuara do të kryhen me konsideratën e minimizimit të të gjitha cënimeve të interesave publike apo private.

Ndikimi në burimet arkeologjike dhe kulturore

Nuk evidentohen vende arkeologjike dhe kulturore pranë në mënyrë që të merren masat e duhura dhe të vazhdueshme ndaj tyre.

Ndryshimet tokësore

Këto veprimtari përfshijnë përmirësimin e zonës përrth fabrikës, përgatitjen e shesheve të ambienteve rreth fabrikes, kullimin e shesheve, largimin e mbeturinave, ngarkimin dhe shkarkimin e materialeve dhe veprimtari të tjera të nevojshme për t'u kryer.

VI. INFORMACION PËR KOHËZGJATJEN E MUNDSHME TË NDIKIMEVE NEGATIVE TË IDENTIFIKUARA

Impaktet potenciale në mjedis të zhvillimit të projektit ndahen në dy grupe:

- Efekte të perkoheshme (në terma afatshkurter) që mund të ndodhin gjatë fazës së sistemimit dhe pastrimit te fabrikes për shkak të këtij aktiviteti;
- Eefekte të qendrueshme (afatgjata) që kryesisht do të shfaqen gjatë funksionimit të fabrikës.

Efektet e perkoheshme do të jene të rigjenerueshme me kohe, kështu që mund të tolerohen me shume se sa ato të qëndrueshme që do të kene një imapkt të vazhdueshem në mjedis.

6.1. Analiza e ndikimit të perkoheshëm gjatë sistemimit të zones perreth fabrikes

Kjo veprimtari e punimeve të sistemimit të zones perreth të fabrikes do të ketë një kohëzgjatje relativisht të shkurtër (disa javë) falë teknikës dhe teknologjisë së re dhe moderne që sot ka hyrë në punimet sistemuere. Kështu që vetëm për punonjësit do të vihen ré prania e mjeteve, zhurmave apo trafikut, ndërsa për kalimtarët e rastit nuk do të jetë ndonjë bezdi fakti i të qenit të një aksion sistemimi, aq më tepër që zona në fjalë është me burimin e ujit ekzistuese. Ndikimet negative të pastrim dhe sistemim nuk përfshijnë dëmtimin direkt potencial ndaj florës dhe faunës në zonat e gërmimit dhe të hedhjes së materialit të gërmuar, ndërthurjen e transportit të materialit të gërmuar me trafikun ekzistues tokësor dhe ndotjen e zhurmën gjate punës së pajisjeve gërmues. Ky impakt konsiderohet i vogel, pasi keto punime do të perfundojne menjehere brenda një periudhe të shkurter kohë për sistemimin e zones rreth godines së fabrikes dhe kullimin e ujrave për të shmangur lagështirën. Për më teper, efekti është i shkrutër dhe kushtet normale do të rikthehen pas perfundimit të punimeve të sistermimit.

6.2. Analiza e ndikimit të perkoheshëm nga Zhurmat në punimet e sistemimit

Në konceptin fizik nuk ka asnjë dallim midis tingullit dhe zhurmës. Tingulli është një perceptim ndjesor dhe konfiguracioni kompleks i valëve zanore është përcaktuar (quajtur) me termat: zhurmë, muzikë, fjalë, etj. Zhurma është përcaktuar edhe si tingull i padëshirueshëm. Të gjitha matjet marrin parasysh përmbajtjen e frekuencës së zhurmës, nivelet e presionit akustik global dhe ndryshimin e këtyre niveleve në kohë. Për të krijuar një ide mbi nivelin e zhurmave po japim një tabelë krahasimore të zhurmave për mjedise të ndryshme.

Niveli Tingullit	Pikënisja dëgjimit	Pëshpërime	Biseda	Trafiku Qytetit	Koncert Rock	Motor Jet 10 m larg
dB(A)	0	30	60	90	120	50

Gjatë fazes së sistemim dhe sheshim te zones rreth fabrikes, si pasoje e rritjes së volumit të materialeve do të rritet niveli i zhurmave në kete zonë. Zhurma nuk do të jetë shqetësim kryesor në zonat rrethuese të vendit të përzgjedhur. Niveli i zhurmave krijuar nga punimet ne kete fabrike pritet te jetë i papërfillshëm dhe jo mbi normat e lejuara. Rritja e nivelit të zhurmave shkaktohet kryesisht nga aktivitetet e ngarkim/ shkarkimit dhe levizjet e mjeteve transportuese. Oraret e punës do të kufizohen në përputhje me standartet kombetare. Me zhurmat janë të lidhura dhe shqetësimet nervore, streset dhe pagjumësia. Zhurmat mund të shkaktojnë çrregullime të gjumit, çrregullime të komunikimit, dëmtime në dëgjim, efekte

kardiovaskulare, efekte psikologjike, mërzitje deri në ndryshime të sjelljeve sociale. Ekspozimi për pak kohë në zhurma më shumë se 140dB(A) sjell shurdhim të menjëhershëm. Ndërsa ekspozimi për disa vjetë në zhurma mbi 85 dB(A) sjell një shurdhim gradual. Ekranet akustikë të qarkullimit si dhe përdorimi i materialeve kundra zhurmave në ndërtim, ulin nivelin e dëgjimit të zhurmave nga 5-15dB.

6.3 Analiza e ndikimit të perkoheshëm në biodiversitet gjatë sistemimit të zones rreth fabrikës

Ndikimet negative të shkaktuara në biodiversitet nga dridhjet dhe zhurmat kanë vetëm rrugë reduktimi siç është përcaktuar në uljen e niveleve të tyre. Përsa i përket humbjes së biomasës në territorin që do të shfrytëzohet, habitateve të fragmentizuara do të merren masat si rigjëlberimi përreth territorit të fabrikes që do të rrisë sipërfaqet e gjelbëruara, gjë e cila garanton diellzimin e nevojshëm dhe nxitjen e zhvillimit të specieve të tjera spontane. Në këtë mënyrë mund të sigurohet një vazhdimësi natyrore e vegjetacionit në zonat përreth.

6.4. Analiza e ndikimit të perkoheshëm në ujëra sipërfaqësore në sistemim të zones se fabrikes

Punimet e sistemimit të kësaj fabrike nuk do të ketë ndikime negative në modelin drenazhues të tokës pasi nuk do të prek sisteme të ndryshme të ndërtuara ose të projektuara drenazhimi.

6.5. Analiza e ndikimit të perkoheshëm në ndryshimet e karakteristikave hidrografike gjatë sistemimit të zones rreth fabrikes

Ushtrimi i këtij aktiviteti në kushte optimale në këtë zonë, nuk do të ndikojë në nivelin e ujrave tokësore, në rrugët ujore dhe në rrjedhën e ujrave nëntokësore.

6.6. Analiza e ndikimit të perkoheshëm nga derdhje aksidentale e sedimentit gjatë sistemimit (derdhje e naftes)

Gjatë punimeve të sistemimit, risku i derdhjes aksidentale të karburantit në tokë duhet të merret parasysh në planin e menaxhimit mjedisor. Rreziku i derdhjeve të vajrave gjatë punimeve të sistemimit nuk do të jetë prezentë pasi një sasi e caktuar makinash do të jenë duke punuar jashtë fabrikës.

6.7. Analiza e ndikimit në aktiviteti human

Transporti lokal në zonë nuk do të ndikohet negativisht nga rritja e trafikut të mjeteve të renda dhe e cilimeve në ajër të motorreve të tyre. Operacionet në sistemimit të *kësaj fabrike* nuk do të ndikojnë në rrugën lolale të zonës.

6.8. Analiza e ndikimit të perkoheshëm në Sigurinë e shendetit dhe mjedisit gjatë sistemimit

Veprimtaritë e sistemimit të ketyre llojeve nuk do të paraqesin risk për punonjesit. Rreziqet domethënëse janë incidentet me makinat lëvizëse dhe ndikimi i zhurmave tek punetoret. Do të respektohen kërkesat kombetare të shendetit dhe sigurisë., duke përdorur teknika dhe metoda miqësore ndaj trajtimit të mjedisit. Kjo pershkruhet e detajuar në Planin e Menaxhimit të Mjedisit.

VII. TË DHËNA PËR SHTRIRJEN E MUNDSHME HAPËSINORE TË NDIKIMIT NEGATIV NË MJEDIS

7.1 DISTANCËN FIZIKE NGA VENDNDODHJA E PROJEKTIT

Distanca e ndikimit në mjedis nuk mund dhe nuk do të jetë jashtë territorit të zonës e cila do të jetë objekt sistemimi dhe funksionimi i nje fabrike imbutilimi dhe ambalazhimi i ujit te pijshem per tu tregetuar tek konsumatorët.

7.2 VLERAT E NDIKUARA

Ky projekt në skemën e tij do të përmbajë elemente, që sigurojnë marrjen e masave në rast anomalie apo avarish, që mund të jenë deri në çenim të veprës. Hartimi i projektit të cekët apo me mangësi, zbatimi i punimeve me cilësi të dobët që bëhen burim avarish, janë shkaqet që sjellin pasoja të rënda në mjedis. Vec punonjësve që mund të preken nga pakujdesitë e punës dhe ndikimet e tyre nuk do të ketë ndikime të tjera jashtë këtyre ambienteve kjo edhe për shkak të rrethimit të fabrikës. Në rastet kur nuk është identifikuar asnjë masë zbutëse ose kur ndikimi nuk mund të zbutet siç duhet, VNM-ja ka trajtuar ndikimet e mbetura ose “reziduale”. Ndikimet reziduale shqyrtohen për secilin aspekt mjedisor dhe për nivelin e tyre të identifikimit.

<i>Burimi i Ndikimeve</i>	<i>Objekti mbi të cilin bien</i>	<i>Lloji i ndikimit</i>
Rritja e intensitetit të transportit	Banorët vendas	- , rritja e nivelit të zhurmave
Ndotje akustike	punonjësit	- shqetësim për punonjësit.
Zhvillimi i punimeve të sistemimit te zones rreth fabrikes	Punonjësit, Banorët vendas	- -, Rritje të mundësisë për aksidente

Shpjegim :

- , Ndikim negativ i konsiderueshëm
- -, Ndikim negativ i lartë
- - -, Ndikim negativ shumë i lartë
- ?, Ndikim negativ që mund të mos ndodhë, por që duhet marrë në konsideratë.
- +, Ndikim pozitiv
- + +, Ndikim pozitiv i konsiderueshëm
- +++ , Ndikim pozitiv shumë i lartë.

Ky aktivitet kërkon një fokusim të gjerë për zbutjen e ndikimeve negative dhe rritjen e atyre pozitive gjatë aktivitetit të punimeve të sistemimit të zones rreth fabrikës.

Trafik i ri shtesë i krijuar

Lëvizjet e kamionëve për dërgimin e kolive të ujit do të parashikohet që të ndodh në kohën me më pak trafik në rrjetin rrugor lokal, me qëllim që të ndërthuret sa më pak me trafikun normal të zonës suburbane dhe urbane. Kësisoj, do të jetë e udhës, që më mirë lëvizjet të kryhen kryesisht në intervalin kohor 17-07.

VIII. MUNDËSINË E REHABILITIMIT TË MJEDISIT TË NDIKUAR

8.1. MUNDËSINË E KTHIMIT TË MJEDISIT TË NDIKUAR NË GJËNDJEN E MËPARSHME

Rehabilitimi është procesi i zbulimit të ndryshimeve, nëse ato do të ndodhin, i përcaktimit të drejtimit dhe i matjes së shtrirjes të tyre. Objektivi themelor i këtij kapitulli është që të ofrojë rekomandime të përshtatshme për rehabilitimin dhe njëherësh mbrojtjen e zonës, mbrojtjen e shëndetit të punonjësve, të mbrojtjes së cilësisë së ujrave sipërfaqësorë dhe nëntokësorë, si dhe të mbrojtjes së cilësisë së tokave në mënyrë që ai të shërbejë realisht për promocionin publik të gjithë zonës përreth. Mjedisi nuk modifikohet aq sa të mund të mos kthehet në gjendje të mëparshme, kështu mundësitë e kthimit në gjendje të mëparshme janë plotësisht të lehta dhe të riparueshme brenda pak ditëve. Masat dhe veprimet për sistemin dhe përgatitjen e vendit, për parandalimin e erozionit, për gjelbërimin dhe rigjelbërimin, si dhe ndërhyrjet e vazhdueshme që sigurojnë mirmbajtjen e habitatit.

8.2. MASAT REHABILITUESE TË RIGJELBËRIMIT DHE GJELBËRIMIT

Masat rehabilituese në planet e rehabilitimit identifikohen në përputhje me karakteristikat e vlerat e habitatit. Ato jepen të detajuara, duke u grupuar në:

- a) punime inxhinierike;
- b) punime biologjike.

Rigjelbërimi i habitatit me bimësi kryhet, duke i dhënë përparësi bimëve autoktone, të përshtatshme me zonën, që kanë ekzistuar para kryerjes së punimeve të ndertimit të fabrikes, si dhe bimësisë tjetër që është në përputhje me tipin e tokës. Llojet pyjore që përdoren për ripyllëzimin e sipërfaqes rreth dhe në brendësi të objektit në studim, duke pasur parasysh:

- për mbrojtjen e tokave nga erozioni të përdoren llojet fletore përherë të blerta;
- për veshjen e terreneve shkëmbore të përdoren llojet pyjore të cilat kanë sistem rrënjor të fuqishëm, e mbajnë të mbuluar tokën edhe gjatë stinëve me rreshje të bollshme dhe e lidhin mirë atë;
- për terrene me shfaqje të erozionit duhet të përdoren dhe llojet që lidhin mirë terrenin dhe ndihmojnë parandalimin e erozionit;
- për terrene të eroduara, krahas fidanëve, të përdoret edhe mbjellja me farë.

Pas mbarimit të të gjitha operacioneve rehabilituese, subjekti do të dorëzojë projektin e rehabilitimit ambjental të përfunduar në mënyrë të kënaqshme dhe në përputhje me kërkesat e planit të rehabilitimit.

Sistemimi dhe përgatitja e vendit

Hapi i parë në operacionin e rehabilitimit është pastrimi i përgjithshëm dhe sigurimi i zonës.

Masa të sugjeruara

Punimet e pastrimit të vendit që ndërmerren pas ndërprerjes së veprimtarisë përfshijnë:

- largimin e të gjitha pajisjeve të fiksuara dhe të palëvizshme, të përkohshme dhe të përhershme;
- largimi dhe eliminimi i duhur i të gjitha llojeve të mbetjeve;
- pas pastrimit të vendit mund të jetë i nevojshëm pengimi i hyrjes së njerëzve dhe kafshëve deri në rehabilitimin total të zonës.

Hapi i parë në procesin e përgatitjes përfshin rimodelimin e zonës ku duhet të modelohet në mënyrë të tillë që të harmonizohet me peizazhin rrethues. Vendi duhet lënë në një gjendje të qëndrueshme, lehtësisht të kulluar që të harmonizohet me zonën rrethuese. Shtresa e tokës duhet të ripërhapet në mënyrë uniforme mbi zonë në një thellësi të përshtatshme për të mbështetur rigjëlberimin.

Rigjëlberimi

Vegjetacioni është stabilizuesi më i mirë i mirëmbajtjes së thjeshtë të zonave të degraduara në periudhë afatgjatë. Rigjëlberimi i shërben parandalimit të erozionit. Rigjëlberimi gjithashtu minimizon ndikimin e ndërhyrjes pamore.

Masa të sugjeruara

- Rigjëlberimi do të synojë instalimin e bimëve autoktone. Instalimi i tipeve të vegjetacionit jo autokton, mund të kërkojë më shumë burime se riinstalimi i vegjetacionit origjinal. Tokat për llojet e huaja duhet të jenë relativisht pjellore dhe mund të jenë të nevojshme trajtimet e mirëmbajtjes, si plehërimi dhe krasitja.
- Shtresa e materialit organik, me të cilin do të mbulohet sipërfaqja e tokës për të parandaluar erozionin rreth fidanëve që rriten, mund të reduktojë barërat e këqija dhe të ruajë lagështinë e tokës dhe shtimin e ushqyesve dhe lëndës organike të dobishme. Ndër materialet që mund të përdoren përfshijnë: komposto, mbetje druri, copëra, pluhura sharre, kashtë, levore etj.

Mbjellja - Në rastet më të shumta, rigjëlberimi do të përfshijë rifutjen e llojeve të bimëve të përshtatshme për të plotësuar rigjenerimin me anë të erës ose farës së ruajtur në tokë. Kjo rifutje mund të jetë në formën e fidanëve të shtuar në fidanishte ose aplikimi i drejtpërdrejtë të farës në shtratin e farës të përgatitur.

Monitorimi dhe mirëmbajtja - Rehabilitimi është një proces që mund të shkojë me vite për të dhënë një ekosistem të qëndrueshëm dhe vetë qëndrues. Kujdesi i mëpastajshëm është vitalisht i rëndësishëm dhe çdo dështim duhet të riparohet shpejt.

8.3. MASAT PËR TË RUAJTUR EKUILIBRIN MJEDISOR

- Hapjen dhe pastrimin (mirëmbajtjen) e kanaleve kolektorë, gjatë gjithë gjatësisë përreth fabrikes për moslejimin e hyrjes së rrjedhjeve ujore e të mbatjeve të ngurta në territorin përreth dhe daljen prej tyre drejtpërsëdrejti në rrjedhjen e ujrave sipërfaqësore.
- Respektimin e formave të relievit ekzistues në zonat përreth.
- Sheshimi i tokës pas perfundimit të punimeve të sistemit të zones përreth fabrikes.
- Zbatimi me rigorozitet rregullorja e sigurimit dhe shfrytëzimit teknik;
- Kthimi në gjendjen e mepareshme të vendeve ku kryehen punimet, pas perfundimit të tyre.

8.4. KOSTOT FINANCIARE TË PËRAFËRTA PËR REHABILITIM

Ndikimet negativë të parashikuar nga punimet e pastrimit dhe sistemimit te fabrikes mund të minimizohen, duke u shoqeruar me një kosto paraprake për masat e rehabilitimit. Masat zbutëse për fazat operuese përmbledhen në tabelat e mëposhtme. Këto tabela identifikojnë masat zvogëluese, që duhet të zbatohen për të minimizuar efektet e parashikuar për çdo veprimtari. Të gjithë aspektet e planit zbutës përfshihen në praktikat e mira të inxhinierisë dhe praktikat më të mira të menaxhimit dhe si rezultat është e përfshirë në kostot aktuale të projektit.

<i>Aktiviteti</i>	<i>Efektet potenciale</i>	<i>Plani i zvogëlimit</i>	<i>Përgjegjësia</i>	<i>Kosto e përafërt</i>
Vendi i punësi pastër dhe shkallëzimi	Mungesë pemësh	Pemët nuk do të preken nga vendi i punës. Asnjë pemë që nuk ka lidhje me vendin e punës, nuk do të pritët.	Komp Kontraktor	\$400
Vendi i punës i pastër dhe shkallëzimi	Ndërhyrja në dranzhimin e vendit dhe të erozionit të tokës	Shkallëzimi final i vendit do të lehtësojë dhe do të shmang përmbytjet dhe pellgjet. Një plan dranzhimi i vendit do të bëhet për mbrojtjen nga erozioni. Vendosja e tabelave sinjalizuese dhe rrethimi me rrjet do të minimizoj ndotjen e ajrit gjatë punimeve të sistemimit.	Komp Kontraktor	\$200
Vendi i punës i pastër dhe shkallëzimi	Zhurma nga paisjet	Paisjet e kryerjes së punimeve duhet të jenë sipas direktivave standarte të Komunitetit Europian 2000/14/EC të maj 2000. Kjo Direktive aplikohet tek prodhuesit e paisjeve, që bëjnë zhurma. Zhurma gjatë punës duhet të minimizohet gjatë kohës së pushimit. Të gjitha paisjet duhet të mbahen në kushte të mira.	Komp Kontraktor	Të vogla
Përmirësimi i vendit të punës dhe të rrugëve	Pluhuri	Vaditja e sipërfaqeve të vendit të punës, ashtu siç nevojitet do të minimizojë pluhurin. Të gjitha paisjet duhet të mbahen në kushte shumë të mira.	Komp Kontraktor	\$300
Kullimi	Ndotja nga mbetjet	Atje ku gjurmimet kërkojnë kullimin. Uji i tepërt duhet të drenazhohet në derdhjet në sistemin e kullimit.	Komp Kontraktor	\$200
Vendndodhja e territorit të fabrikës	Konfliktet me përdoruesin aktual të tokës	Zona e fabrikës nuk është sipërfaqe bujqësore, por prone private e firmes	Komp	Të vogla
Vendndodhja e territorit të fabrikës	Problemet me komunitetin	Të gjitha lejet dhe aprovimet do të merren nga autoritetet e duhura përpara operimit në vend.	Komp Kontraktor	\$1,000
Vendndodhja e territorit të fabrikës	Sipërfaqet e zëna më aktivitet	Sipërfaqja e punimeve të sistemimit përreth fabrikës do të ripunohen për tu përzier me ambientin përreth. Ribimësia duhet të kryet në përputhje me bimësinë lokale. Të gjitha vendet e punës do të kthehen në kushte të qëndrueshme.	Komp Kontraktor	\$ 400
Caktimi i vendit për materialet e gërmuara në është e nevojshme.	Ndërhyrja në kullimet natyrale	Shuma e materialeve të predispozuar duhet të minimizohen nga marrja vetëm aq sa duhet.	Komp Kontraktor	Të vogla

Caktimi i vendit për materialet e gërmuara në është e nevojshme.	Shqetësimet me tokën	Autoritetet lokale duhet të aprovojnë vendodhjen e caktuar. Ajo nuk duhet të ndërhyjë me tokën lokale në përdorim. Bimësia duhet të kryhet në përputhje me bimësinë lokale. Të gjitha pjerrësitë dhe vendet e punës të kthehen në kushte të qëndrueshme.	Komp Kontraktor	\$ 200
Ndërlidhja e sistemit të transmetimit	Shqetësimet me tokën.	Asnjë tokë bujqësore nuk preket nga ndertimi i fabrikes.	Komp Kontraktor	Të vogla
Burimet e mbulimit te gropave	Zvogëlimi i burimeve lokale	Nuk do të ketë burime të tjera. Do të përdoren dherat e gërmuara për mbulimin e gropave që do krijohen gjatë punimeve te sistemit te fabrikës	Komp Kontraktor	Të vogla
Forca ndërtuese	Fluksi i punëtorëve që krijon presion në shtëpitë dhe burimeve të tjera	Fluksi i të punësuarve nuk do ti kalojë 5-8 persona. Punëtorët duhet të jenë banorë të zonës përreth. Një qendër e ndihmës së shpejtë do të sigurohet për punëtorët në fabrikë.	Komp Kontraktor	\$100
Shpërndarja e paisjeve dhe e materialeve	Rritja e trafikut dhe e pluhurit	Pluhuri do të minimizohet me vaditjen e shesheve të punimeve gjatë punimeve të sistemit perreth sones së fabrikës. Shpejtësia në rrugë duhet të kontrollohet për të zvogëluar rrezikun e aksidenteve.	Komp Kontraktor	\$100
Vend të caktuar për mbeturinat solide	Problemet potenciale shëndetit	Mbeturinat qe do krijohen nuk do të hidhen në vend e pavend, por do të hiqen nga nje kontraktor i licensuar.	Komp Kontraktor	\$100
Vendndodhja finale	Estetika	Tokat do te gjelbërohen në mënyrën më të përshtatshme.	Komp Kontraktor	\$200

IX. MASAT E MUNDSHME PËR SHMANGIEN

9.1 MASAT ZBUTËSE E NDIKIMEVE NEGATIVE NË MJEDIS

Ndikimet negative kërkojnë hartimin e masave zbutëse dhe rikuperimet për ndikimet negative dhe kjo realizohet me anë të tre metodave të mundshme:

- *Evitimi* ose parandalimi i ndikimit;
- *reduktimi* ose korigjimi i ndikimit; dhe
- *kompensimi* ose shlyerja e ndikimit.

Lloji i rekomanduar i zbutjes së ndikimit ka mundësi të varet nga një sërë faktorësh, përfshirë zbatueshmërinë teknike, praktikitetin, resurset dhe kapacitetin e disponueshëm, koston dhe nëse rikuperimi i propozuar është konsistent me planin ose programin e propozuar.

9.2 METODAT PËR ZVOGËLIMIN E NDIKIMEVE NEGATIVE NË MJEDIS

Evitimi ose parandalimi

Parandalimi i ndikimeve negative është opsioni i parë dhe më i miri, në rast se është në linjë me qëllimet e tjera të programit të propozuar. Parandalimi funksionon më mirë kur zbatohet herët në procesin e vendimmarrjes dhe në një nivel strategjik. Sapo janë marrë vendimet kryesore në lidhje me një program të propozuar (psh në rastin e zhvillimit të tokës – shkalla e zhvillimit, vendndodhja dhe lloji i përdorimit i propozuar), rikuperimi ka më shumë mundësi të fokusohet në reduktimin ose shmangien e ndikimeve.

Reduktimi ose korigjimi

Reduktimi i ndikimeve negative ka mundësi të jetë metoda më e zakonshme. Dëmtimi në mjedis mund të jetë i pranueshëm, por kur mbahet brenda kufijve të pranueshëm. Korigjimi i ndikimeve negative është i ngjashëm me reduktimin, përveçse kryhet pasi kanë ndodhur ndikimet, për shembull rimbjellja e vegjetacionit të dëmtuar. Masat për shmangien e efekteve negative jnaë në 3 drejtime:

- Me karakter teknik
- Me karakter organizativ
- Kontrolli dhe monitorimi në kohë

Kompensimi ose shlyerja

Kompensimi ose shlyerja e ndikimeve përfshin krijimin e një përfitimi mjedisor i cili kompenson për një dëmtim tjetër mjedisor. Vështirësia e kompensimit qëndron në sigurinë që do të kryhet.

9.3. VLERËSIMI I MASAVE PËR ZBUTJEN E NDIKIMEVE NEGATIVE NË MJEDIS

Në rastet kur ndikimi nuk mund të zbutet siç duhet, VNM-ja ka trajtuar ndikimet e mbetura ose “reziduale”. Ndikimet reziduale shqyrtohen për secilin aspekt mjedisor dhe për nivelin e tyre të identifikimit. Një përmbledhje e ndikimeve të identifikuara të projektit dhe e mjeteve zbutëse dhe menaxhuese jepet në këtë tabelë:

Tabela e Identifikimi i ndikimeve dhe masat zbutëse

Zona e ndikimit	Çështjet kryesore	Rëndësia	Masat zbutëse kryesore
Cilësia e ajrit	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Çlirimet prej impianteve të menaxhimit të fabrikës 	<ul style="list-style-type: none"> ▪ E papërfillshme 	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Plan i kontrollit të cilësisë së ajrit
Zhurmat & Dridhjet	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Shpërthimet, trafiku i automjeteve të fabricës 	<ul style="list-style-type: none"> ▪ E përfillshme 	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Plan i kontrollit të zhurmës dhe dridhjeve
Hidrologjia & Resurset ujore	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Shfrytëzimi i burimeve ujore 	<ul style="list-style-type: none"> ▪ E vogël, e pafavorshme 	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Plan i menaxhimit të ujërave ▪ Plan i kontrollit të derdhjeve
Bota bimore dhe shtazore	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Shfarsja e habitateve në zonën e fabrikës 	<ul style="list-style-type: none"> ▪ E papërfillshme 	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Plani i mbrojtjes së habitateve, botës bimore dhe shtazore ▪ Plan i menaxhimit të sipërfaqes së gjelbër
Trashëgimia kulturore	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Asnjë sit i njohur arkeologjik brenda zonës 	<ul style="list-style-type: none"> ▪ E papërfillshme 	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Politikat e “zbulimeve të vona”
Trafiku & Transporti	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Trafiku nga fabrika ▪ Aksidentet rrugore 	<ul style="list-style-type: none"> ▪ E vogël ▪ E përfillshme 	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Ndërtimi i rrugëve së shërbimit për fabricës ▪ Plan i kontrollit të zhurmës dhe dridhjeve ▪ Plan i parandalimit të ndotjeve
Pamor	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Pamja e gropave të krijuara, 	<ul style="list-style-type: none"> ▪ E pafavorshme 	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Plan i kontrollit të erozionit
Social-ekonomik	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Punësim lokal dhe rajonal ▪ Rikthim i krahut të punës në zonë 	<ul style="list-style-type: none"> ▪ E moderuar, e favorshme 	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Plan i lidhjeve me komunitetin ▪ Plan i burimeve njerëzore

Pas identifikimit të ndikimeve kryesore në shoshitjen e ndikimeve trajtohen madhësitë e këtyre ndikimeve për të arritur të jepet një pasqyrë sa më e qartë e mundësive dhe mënyrave të zbutjes së ndikimeve negative kryesore dhe e rritjes sa më të mundshme të atyre pozitive.

9.4. MASAT E SHMANGIES SË NDOTJES SË AJRIT

Ndotja mund të vijë, si nga pluhuri që krijohet vetëm nga punimet e pastrimit dhe sistemimit të zones perreth godinës së fabrikës së ambalazhimit të ujit të pijshëm, si dhe nga rritja e lëvizjes së mjeteve të motorizuara dhe të rënda. Masat për uljen e nivelit të pluhurave të gjeneruara nga punimet e pastrimit dhe sistemimit të zones perreth godinës së fabrikës janë në mirëmbajtjen e cilësisë së vendit të punës, si dhe rrethimin me rrjeta të dendura dhe me veshje të kostumeve mbrojtëse të punonjësve të kantierit në ambientet e punës. Por këtu duhet të theksohet se ky tip ndotje është shumë i kufizuar, pasi ndodh vetëm në periudhën kohore të sistemimit të zones perreth fabrikes. Masat e shmangies së ndotjes së ajrit janë si më poshtë:

- Ulja e nivelit të ndotjes së ajrit nga pluhurat prej shtimit të transportit mund të realizohet me larjen e makinave të objektit;
- Rrugët ndihmëse të fabrikes do trajtohen me ujë, përpara se të kalojnë mjetet e transportit, duke evituar gjenerimin e pluhurave nga sipërfaqet më të largëta;
- Spërkatja me ujë perreth fabrikës gjatë gjithë ditës për të mos ndikuar në prodhimin e pluhurave ashtu siç ndodh rëndomë gjatë kryerjes së punimeve të ndryshme nëpër rrugë.

Masat e uljes së ndikimeve negative të zhurmane

Masat zbutëse kundër zhurmave duke përdorur mjete transporti dhe pajisjesh me nivel të ulët zhurme.

Masat e shmangies së ndotjes së ujërave sipërfaqësore

Ujrat e përdorura për spërkatjen e ambienteve do të grumbullohen dhe do të derdhen në kanalizimet e ujërave të bardha në kanalën magjstral. Sistemimi i zonës perreth kësaj fabrike do

t'i japë mundësi komunitetit të zones furnizimin me uje te pijshem nga burimi i Selites, si dhe do zhvillojë në mënyrë të ndjeshme biznesin e vogel.

Masat e shmangies se ndikimeve në intensitetin e erozionit

Masat zbutëse kundër erozionit janë të dy niveleve kryesore, si masa hidroteknike dhe ajo biologjike, duke realizuar që pjesa e sipërme e terrenit do mbrohet nga rreshqitja me si më poshtë.

- me mur të thatë guri, me gabion, mure betoni
- Nivelimi i sheshit te fabrikes do minimizohet sidomos ne terrenet e pjerta.
- Bordura e poshtme e terrenit të fabrikes, në terrenet e pjerrëta do perforcohet.
- Pasi te perfundojne punimet e sistemim dhe pastrimit te zones perreth fabrikes, rruget hyrese do kthehen ne gjendjen fillestare.
- Ulluqet dhe rrepirat do zhduken, demtimet e kanaleve, tarracave, rrugeve dhe veçorite e tjera te tokes do korrigojen, dhe toka do kthehet ne kushtet e saj te meparshme.
- Rruget hyrese do te jene poshte nivelit te fabrikes per te zvogeluar impaktin erroziv.
- Me qëllim që të sigurohet shmangia e dëmtimit te tokave, do të ndërtohen kanale drenazhimi per kullimin e shirave dhe do të inspektohet në bazë javore ne stinen e reshjeve.

Masat në mbrojtjen nga aksidentet në punë

Punonjësit duhet të pajisen me veshje pune dhe të trajnuar në shërbimin e këtij aktiviteti. Brigada e punonjësve që do të kryejë montimin e paisjeve te imbutilimit dhe te ambalazhimit te ujit te pijshem, duhet të disponojë dokumenta, ku pasqyrohet puna me punonjësit për njohjen dhe zbatimin e rregullave, edhe e dokumentuar me firmat përkatëse për njohuritë bazë në zbatimin e rregullave të sigurimit teknik.

1. Para së gjithash me marrjen në dorëzim të të gjithë dokumentacionit teknik e administrativ, kompania. do të marrë të gjitha masat e organizimit në drejtim të plotësisimit me rigorozitet të rregullave të sigurimit teknik dhe mbrojtjes në punë.
2. Për këtë në ambientet perreth fabrikes do të vihen shenja dalluese, të cilat bëjnë të qartë se këtu kemi të bëjmë me fabrike te prodhimit dhe ambalazhimit të ujit te pijshem, për çdo të huaj. Në hyrje të ambientit të zones së fabrikes vendoset tabela dalluese e shoqërisë.
3. Gjatë kryerjes së aktivitetit të punimeve të sistemimit dhe pastrimit të zones perreth fabrikes do të zbatohet me përpikmëri rregullorja e sigurimit teknik në kete fabrike.
4. Para fillimit të punës duhet të kontrollohet fronti i punës në çdo post pune, kontrolli i gjendjes dhe gadishmërisë së mjeteteve dhe makinerive.
5. Në objekt do të vendosen tabelat e sigurimit teknik që kufizojnë punonjësit apo të huaj për kalimin me vend e pa vend, rrugët e detyrueshme të kalimit për ruajtjen nga ndonjë aksident i mundshëm gjatë veprimtarisë operacionale.
6. Sheshi i ambientit te zones se fabrikes do të rrethohet me rjetë dhe do të lagen gjatë kohës së zhvillimeve të punimeve me makineritë duke perdorur praktika të mira menaxhimi të punimeve gjatë punimeve të sistemim pastrimit te kesaj zone.
7. Punimet në kete fabrike do drejtohen nga një specialist i fushes.
8. Punonjësit duhet të pajisen me veshje pune gjatë orarit të punës.

Në objekt do të regjistrohen dokumenta, ku do pasqyrohet puna me punonjësit për njohjen dhe zbatimin e rregullave, e cila do të bëhet e përjavshme dhe e dokumentuar me firmat përkatëse për njohuritë bazë në zbatimin e rregullave të sigurimit teknik.

9.5. MASAT NË RUAJTJEN E EKUILIBRIT MJEDISOR

- Hapjen dhe pastrimin (mirëmbajtjen) e kanaleve kolektorë, gjatë gjithë gjatësisë përreth fabrikës për moslejimin e hyrjes së rrjedhjeve ujore e të mbetjeve të ngurta në territorin përreth dhe daljen prej tyre drejtpërsëdrejti në rrjedhjen e ujrave sipërfaqësore. Thellësia e kanalit të shkarkimit të ujrave plotëson kushtet e projektit dhe tendenca e tij është në funksion të topografisë së zonës.
- Respektimin e formave të relievit ekzistues në zonat përreth.
- Ngjeshja dhe sheshimin e tokës pas perfundimit të punimeve të sistemimit.
- Zbatimi me rigozitet rregullorja e sigurimit dhe shfrytëzimit teknik;
- Kthimi në gjendjen e me pareshme të vendeve ku do kryehen punimet, pas perfundimit.

Përdorimi i praktikave më të mira të sistemimit dhe menaxhimit perreth fabrikes

Përdorimi i pajisjeve të përshtatshme, përshtatja me rregulloret ndërkombëtare dhe zbatimi sipas standarteve dhe teknikave më të mira të punimeve të sistemimit te zones perreth fabrikes, janë një kërkesë thelbësore për zgjedhjen e kontraktorëve dhe plotësimin e suksesshëm të projektit. Kjo do të sjellë përfitime të dukshme për zbutjen e ndikimit në mjedis të sistemimit dhe menaxhimit të zones perreth fabrikës.

9.6 MASAT SOCIAL-EKONOMIKE

Zvogëlimi i ndikimeve social ekonomike nga projekti i të sistemimit dhe funksionimit të fabrikës për prodhimin dhe ambalazhimin e ujit te pijshem te Burimit Selita & ShëmMëria përfshin përpjekjet për shmangien e keqkuptimeve për punësim afatgjatë të punëtorëve lokalë, edukimin e popullatës mbi natyrën jo spekulative të funksionimit të projektit në fjalë, duke patur parasysh kompesimin si dhe trajtimin me respekt të banorëve të zonës. Operatori, ka bërë dhe po vazhdon të bëjë një punë të planifikuar dhe të kujdesshme, për realizimin e ketij projektin deri ne zbatim. Për çdo të papritur që mund të ndodh gjatë zbatimit të projektit, operatori ka marrë masa të lajmërojë autoritetet e pushtetit vendor dhe të veprojë në përputhje me ligjin Shqiptar në fuqi.

Plani i menaxhimit të ambientit

Çdo veprimtari e rëndësishme që kryhet në marëdhënie me mjedisin, duhet të parashikojë në projektin e saj edhe Planin e Menaxhimit të Mjedisit (PNM), qëllimi i të cilit është parandalimi, minimizimi dhe mënjanimi i ndikimeve negative ndaj mjedisit të veprimtarisë që propozohet të kryhet. Duhet theksuar që Plani i menaxhimit të mjedisit është në interes të të gjithëve kundrejt plotësimit të kërkesave. Plani i menaxhimit të ambientit do të përqëndrohet dhe fokusohet në mënyrë që të garantohen kushte normale të kryerjes së punimeve gjatë fazës së punimeve të të sistemimit, funksionimit, si edhe të krijimit të ambienteve të shërbimit dhe punës sipas standarteve bashkohore duke shtuar sigurinë e kushteve të punës së punonjësve dhe shmangien e aksidenteve në ambientet ku punohet, dhe shqetësimin e banorëve të zones.

Plani i pjesëmarrjes per konsultimin publik dhe prezantimi i planit

Operatori do të drejtojë veprimtarinë e pjesëmarrjes publike në përputhje me legjislacionin Shqiptar në fuqi. Ai do të përgatisë një listë të urdhëresave të qeverisë lokale, të cilat do të informohen mbi planet e ecurisë dhe konkluzionet e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis dhe institucionin qëndror (Ministrinë e Mjedisit). Ai do të organizojë edhe një mbledhje me pjesëmarrjen publike të ambientalistëve rajonalë dhe të njerëzve që janë të ndjeshëm ndaj problemeve të mjedisit. Stafi i tij duhet të ndërëgjegjësojë opinionin publik mbi llojin e projektit, kohëzgjatjen e tij, masat që ka planifikuar të marrë per zbutjen e ndikimeve negative të mundshme, shpërblimin në rast dëmtimeve të pronarëve, mundësinë e punësimit vendor, pra, gjithçka që do të bëhet, do të ketë per bazë respektimin në maksimumin e mundshëm të mjedisit.

X. NDIKIMET E MUNDSHME NË MJEDISIN NDËRKUFITAR

Objekti në studim nuk do të ketë ndikime në mjedisin ndërkufitar pasi ndodhet në Bashkinë e Tiranës dhe është një fabrikë e cila prodhon ujë dhe nuk ka ndikime mjedisore reziduale që mund të përhapen në distanca të mëdha që të rrezikojnë vendet fqinje.

XI. PËRFUNDIME DHE REKOMANDIME

11.1. PËRFUNDIME

1. Procesi i vlerësimit të ndikimit në mjedis bazohet në Legjislacionin shqiptar dhe atë ndërkombëtar
2. Procesi i vlerësimit të ndikimit në mjedis siguron një përmbledhje të informacionit të disponueshëm në përputhje me kushtet e vend-ndodhjes së aktivitetit,
3. Procesi i vlerësimit të ndikimit në mjedis paraqet masa lehtësuese për të minimizuar ose për të ndaluar ndikimet sociale dhe mjedisore të projektit. Këto përfshihen në një Plan Menaxhimi Ambiental (PMA),
4. VPNM përfshin parashikimin dhe planifikimin e masave zbutëse të ndikimeve të projektit në mjedisin fizik dhe social.
5. VPNM është një proces që zhvillohet brenda procesit të planifikimit dhe zbatimit të projektit.
6. Qëllimi i VPNM nuk është të pengojë zhvillimin ekonomik por të balancojë faktorët ekonomikë, teknikë dhe ambienta me kostot përkatëse, si dhe të përmirësojë cilësinë e planifikimit dhe të zhvillimit.
7. Zona në studim ndodhet në komunën e Dajtit.
8. Ky raport synon, analizimin e faktorëve pozitivë e negativë mjedisore, dhënien e masave zbutëse, si për reduktimin e ndikimeve negative, dhe tenton përmirësimin e vlerave ekologjike të territorit pas ndikimit të mundshëm në mjedis të fabrikes.
9. Ligji Nr. 10440 dt. 07.07.2011 “Mbi vlerësimin e ndikimit në mjedis” synon një vlerësim të përgjithshëm, të integruar dhe kohor të impaktit në mjedis të projekteve dhe veprimtarive që zbatohen, duke parandaluar dhe/ose kufizuar impaktin negativ në mjedis; një proces të hapur vlerësimi, të kryer në mënyrë të pa anëshme ndërmjet pjesëmarrjes së organeve qendrore dhe vendore, antarëve të publikut, organizatave jo fitimprurëse, sponsorëve të projektit dhe personave të specializuar në këtë fushë.
10. Zonat e Mbrojtura janë të konsideruara si pjesë/sipërfaqe e tokës dhe/ose ujit, detare/bregdetare, të destinuara kryesisht për konservimin e biodiversitetit, burimet natyrore, që shoqërojnë atë/ato dhe që janë të menaxhuara në mënyrë të ligjshme dhe/ose në mënyra të tjera efektive, por që në rastin tonë ndohen jashtë zonës së mundshëm të ndikimit në mjedis.
11. Kushtet klimatike mesdhetare dhe kushtet e veçanta ujore të këtij ekosistemi kanë përcaktuar një mbulesë bimore dhe një botë shtazore të larmishme. Bimësia dallohet për periudhën e gjatë të vegetacionit mbi 10 muaj.
12. Nga pikëpamja hidrogeologjike, rajoni bën pjesë në pellgun e madh artezian të Ultësirës Perëndimore, i cili është i pasur me ujra nëntokësore. Kjo është e kushtëzuar nga përhapja e shkëmbinjve me veti të mira dhe mesatare kolektore (zhavorre dhe konglomeratë), nga kushtet e favorshme klimatike me reshje rreth 1100 mm/vit, nga një rrjet i dendur hidrografik dhe me relief fushor me pjerrësi të vogël drejt perëndimit.
13. Projekti do të bëjë që të ketë punësim të vazhdueshëm; do sigurojë investime të drejtpërdrejta në komunitetin lokal; do krijojë të ardhura financiare dhe ekonomike në zonë; ndikimet mjedisore që janë identifikuar të eliminohen, reduktohen ose zbuten nëpërmjet zbatimit të planit të menaxhimit të mjedisit.
14. Sipas studimit të deritanishëm, nuk është identifikuar asnjë “ndikim fatal”, ndonëse ekzistojnë disa ndikime të vogla negative, të cilat do të kontrollohen nga masat zbutëse

- inxhinierike dhe nga ato të lidhura me sheshin. Dhe për më tepër, plani i menaxhimit të mjedisit do të ndihmojë kompaninë investuese për të arritur një përmirësim të vazhdueshëm të mjedisit gjatë gjithë jetë gjatësisë së aktivitetit të rehabilitimit ambjental.
15. Ndikimi në burimet kulturore dhe arkeologjike që rrjedh nga operacionet e sistemimit dhe depozitimit nuk pritet që të ndodhë. Nuk ka vende arkeologjike dhe kulturore, qoftë në vendin e fabrikes, ashtu dhe në atë të depozitimit apo reklamimit të tokës.
 16. Ndikimet negative të sistemimit dhe të hedhjes së materialit të ngarkuar kanë të bëjnë në ndërthurjen e transportit të materialit inerte për mbushje me trafikun ekzistues tokësor, si dhe ndotjen e zhurmës gjatë punës së pajisjeve punuese.
 17. Lëvizja e automjeteve e përqëndruar në një interval dite kohor janë një burim zhurme, por me kohëzgjatje të vogël. Nivelet e zhurmës së krijuar nga lëvizja e automjeteve me llogari teorike mbërijnë në banorët e zones me vlera rreth 40-50 dB(a).
 18. Të gjitha çështjet e planit zbutës do konsiderohen si praktika të mira inxhinierike dhe praktikak më të mira të menaxhimit.
 19. Operatori do të përgatis planet e caktuar të sigurisë, që duhet të përfshijnë: Proçedurat e sigurimit në punë apo rregullat e sigurimit teknik; Proçedurat e mjekimit dhe të ndihmës së shpejtë në raste aksidentesh në punë; Proçedurat e fikjes së zjarrit.
 20. Ndër skenaret e aksidentëve të mundshme do të jenë: Humbjet si rezultat i ngjarjeve të pa parashikueshme; Dëmet nga ngarkesat dhe aksidentet me vinç; Përplasjet e mjeteve në zonën e ndërtimit dhe Mjetet zjarrfikëse;
 21. Në këtë veprimtari që kryhet në marrëdhënie me mjedisin, është parashikuar në projektin e saj edhe Planin e Menaxhimit të Mjedisit (PNM), qëllimi i të cilit është parandalimi, minimizimi dhe mënjanimi i ndikimeve negative ndaj mjedisit të veprimtarisë që propozohet të kryhet.
 22. Ndonëse dihet që punimet e sistemimit dhe pastrimit të zoses perreth fabrikes çlirojnë ndotësa të mjedisit, ndikimet pritet të jenë minimale, sepse do të ketë shembje të kufizuara, sepse sheshi i propozuar i projektit mbi të gjitha është i kufizuar dhe ç'është më e rëndësishmja, nuk përmban struktura ekzistuese. Edhe puna për një nivelim të tij do të jetë mjaft i kufizuar për shkak të vetë gjendjes natyrore të vendndodhjes së sheshit.

11.2. REKOMANDIME

1. Të rifreskohen e të shtohen tabelat dhe sinjalizimet, për të parandaluar zjarrin, aksidentet në punë, si edhe aksidentet automobilistike. Është shumë e nevojshme që të kryhet edhe trajnimi i punonjësve për sigurimin teknik;
2. Këto diapazone duhen të merren parasysh në mënyre të tillë që perioda e vibrimeve vetiakte të objektit që do të sistemohen dhe pastrohen të jetë shumë e ndryshme prej tyre;
3. Të mënjahohen ujërat sipërfaqësorë perreth zones se fabrikes.
4. T'i kushtohet kujdes cilësisë së punimeve të sistemim dhe pastrimit të fabrikes.
5. Të kryhet trajnimi që do të mbulojë kushtet ekzistuese të mjedisit, ndikimet potenciale në mjedis nga projekti i sistemim, implementimin e masave lehtësuese specifike në minimizimin ose eliminimin e ndikimeve negative, dhe masat e përgjithshme mbrojtëse për mjedisin.
6. Investitori të jetë i kujdeshëm në këqyrjen dhe marrjen e masave pararendëse, si në ndryshimin e nivelit të ujërave nëntokësorë, sjelljen dhe reagimin e kafshëve, fryrjen e pjerrësive, fryrjen e sipërfaqeve, etj.

IV. STUDIME MBËSHTETËSE

RAPORTE VLERËSIMI TE NDIKIMIT NË MJEDIS – VNM

Nr.	RAPORTI	AFATI	AUTORI	POROSITËSI
1.	Raport VNM për përcaktimin e venddepozitës së mbetjeve urbane për Bashkitë e Tiranës, Durrësi e Kavajës. 46 faqe	2002	S. Guri M.Guri	Firma “2k Group”,Tiranë”
2.	Raport VNM në karrierën sipërfaqësore në Fushën e sheqit, Vjosa Tarracë 45 faqe	Shtator 2002	S. Guri M.Guri	Firma “2k Group”,Tiranë”
3.	Raport VNM, në karrierën sipërfaqësore në Qafën e Breshërit, Delvinë	2002	S. Guri	Firma “2k Group”
4.	Raport VNM, në karrierën sipërfaqësore në Zonën e Muriqanit, Shkumbin.44 faqe	Tetor 2002	S. Guri M.Guri	Firma “2k Group”
5.	Raport VNM lëndësh inerteje, në karrierën 50 faqe	2002	S. Guri	Firma “2k Group”
6.	RaportVNM për shfrytëzim lëndësh inerteje, në karrierën sipërfaqësore në Adë tarracë, Frakull, Fier. f58	2002	S. Guri M.Guri	Firma “2k Group”Tiranë”
7.	Raport VNM, në karrierën sipërfaqësore në Adë lumë Vjosë, Frakull, Fier. 45 faqe	2002	S. Guri M.Guri	Firma “2k Group”
8.	RaportVNM në karrierën sipërfaqësore në Qafën e Breshërit, Lumi kalasë, Delvin. 50 faqe	Nëntor 2002	S. Guri M.Guri	Firma “2k Group”,Tiranë
9.	RaportVNM, në karrierën sipërfaqësore në Kashisht, lumi Vjosë, Frakull, Fier. 48faqe	Dhjetor 2002	S. Guri M.Guri	Firma “Feleqi” Fier
10.	Raport VNM, në karrierën sipërfaqësore në Kashisht, tarracë, Frakull,	Janar 2003	S. Guri	Firma “Feleqi” Fier
11.	Raport VNM, për Kushtet hidrogeologjike të burimit të Poçemit, për firmën Freskia - 01 53 faqe	Shkurt 2003	M. Guri S. Guri	Firma “2k Group”Tiranë”
12.	Raport VNM i Impiantit të Gazit të Lëngshëm. 117 faqe	Tetor 03	S. Guri	Unioni, Patos
13.	Raport, VNM i Kompleksit Turistik “Xixa”, Golem.	Tetor 03	S. Guri	Shoq.“Xixa”, Golem
14.	Raport VNM për Karrierën e Inerteve Lumore Qedaja-Erzen.	Nëntor 03	S. Guri .	Sho “INCO” sh.p.k.
15.	Raport VNM për Karrierën e Inerteve Lumore Bërzhitë-Tiranë.	Nëntor 03	S. Guri.	Sho.“CARA”sh.p.k.
16.	RaportVNM “Shoqërinë Kaja”, Kompleksi Bar-Restorant-Pishinë, Kolonjë, Lushnje. 43 faqe	2003	S. Guri	Bar rest. Kolonje
17.	Raport VNM të nënstacionit elektrik Elbasan, linjë elektrike Elbasan, nënstacion Berat, nënsatcon Durrës.	Dhjetor 04	G & G	Min. Mbrotjes
18.	Raport VNM në nënstacionin elektrik Berat	Dhjetor 04	G & G	Min.Mbrotjes
19.	Raport VNM në linjë elektrike Elbasan	Dhjetor 04	G & G	Min.Mbrotjes
20.	Raport VNM në nënstacionin elektrik Durrës.	Dhjetor 04	G & G	Min.Mbrotjes
21.	VNM baxho Seman, Velmish, Roskovec, Zharës	Prill 04	G & G	Ll. Mbyeti
22.	VNM Taiwan	Korrik 04	G & G	Rest Bar Taivan
23.	VNM Arsenik, Fier	Korrik 04	G & G	Selca comp.
24.	Studim gjeoteknik, i gjeorreziqeve, raporti i VNM në zonën e Rep. Ushtarak, Poshnjë Berat	Dhjetor 04	G & G	Min. Mbrotjtje
25.	Raport i VNM Euroservisin Fier	Maj 05	G & G	Euroservis
26.	Raport i VNM në Pikën e Karburantit, Seman	Maj 05	G & G	Kujtim

27.	Raport i VNM në linjën e inerteve Fier, Agbes	Maj 05	G & G	Agbes
28.	Raport VNM nënstationit elektrik Bradashesh (Elbasan), nënstationin Sukth, Vlorë, nënstationin Babiçë.	Maj 2005	G & G	KESH
29	Raport i Vlerësim të Ndikimit në Mjedis - VNM Fark	Mars 06	G & G	Komuna Fark
30	Raport i Vlerësim të Ndikimit në Mjedis - VNM për zhvillim të zonës urbane Kashar	Mars 06	G & G	Komuna Kashar
31	Raport i Vlerësim të Ndikimit në Mjedis - VNM për zhvillim të zonës urbane Dajt	Maj 06	G & G	
32	Raport i Vlerësim të Ndikimit në Mjedis - VNM ish kimike	Gusht 2006	G & G	Komp. Planet
33	Studim Riciklimi Plastikës në Shqipëri	Nëntor 2006	G & G	MMPAU
34	Studime Shëngjin	Dhjetor 06	G & G	MMPAU
35	Raport i Vlerësim të Ndikimit në Mjedis - VNM Vlush	Shkurt 07	G & G	Ko.AlbaConstr. tiran
36	Raport i Vlerësim të Ndikimit në Mjedis - VNM Miniera Hekur nikel, Bitincke	Mars 07	G & G	Komp Angleze
37	Raport i Vlerësim të Ndikimit në Mjedis - VNM NGA SHFRYTËZIMI I MUNDSHËM I ujërave të lumit devoll për hec në menkulas, BILISHT	Mars 07	G & G	Komp. Alba Construction, Tiranë
38	Raport i Vlerësim të Ndikimit në Mjedis - VNM Arsenik, Fier	Prill 07	G & G	Ko. Plan Center, Finland
39	Raport i Vlerësim të Ndikimit në Mjedis - VNM HEC, Menkulas	Prill 07	G & G	Komp. Alb Constr. Tiranë
40	Raport i Vlerësim të Ndikimit në Mjedis - VNM Fshat Turistik, Velipojë	Maj 07	G & G	Komp Amerikane
41	Raport i Vlerësim të Ndikimit në Mjedis - VNM HEC, Vlushë	Maj 07	G & G	Ko.AlbaConstrTiranë
42	Raport i Vlerësim të Ndikimit në Mjedis - VNM HEC, i ujërave të Përroit Lenies-Shalësit-Strelçës për hec në zonë e Strelçës, Korçë	Maj 07	G & G	Xh. Ngjeqari
43	Raport i Vlerësim të Ndikimit në Mjedis - VNM HEC, nga shfrytëzimi i mundshëm i ujërave të lumit t vlushës, Skrapar	Maj 07	G & G	Xh. Ngjeqari
44	Raport i Vlerësim të Ndikimit në Mjedis - VNM HEC, mbi rrjedhjen e sipërme të lumit Mat (Hidro/centrali i Stavecit)	Maj 07	G & G	Xh. Ngjeqari
45	Vlerësimi i ndikimit në mjedis i zonës së peshkimit në lagunën e spiakhos, divjakë	Qershor 07	G & G	Kompani Peshkimi, Divjakë



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
Ministria e Ekonomisë,
Tregtisë dhe Energjetikës

LICENCË



LN-1687-06-2010
Kodi: III.2.A (1+2)
Data e lëshimit: 22/06/2010
Afati i vlefshmërisë: Pa afat

SAZAN GURI
NUIS/NIPT: K62101007P
Tirane, TIRANE, Tirane, TIRANE,
Rruga Vaso Pasha, Pallati

Kategoria

Shërbime ekspertize dhe/ose profesionale lidhur me ndikimin në mjedis

Nënkategoria

Veprimtaritë e ekspertizës lidhur me ndikimin në mjedis

Veprimtari specifike

1. Ndikim në mjedis
2. Auditim mjedisor

Specialiteti

Emërtimi përshkrues i veprimtarisë

Veprimtaritë e ekspertizës lidhur me ndikimin në mjedis (auditim mjedisor, ndikim në mjedis).

Kod tjetër:

Kufizime specifike

Licenca ushtrohet sipas kufizimeve në legjisllacionin në fuqi

Detyrime specifike

Licenca ushtrohet sipas detyrimeve në legjisllacionin në fuqi

Vendi i kryerjes së veprimtarisë

Në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë

Nënshkrimi i sportelit: Andonela Heshi

